

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-32


K 87

Viron Kona



ETJE
QË
SHUHEJ

tregime



8JH-32
K 87

VIRON KONA

ETJE QË SHUHEJ

Tregime

LIBRARI E SHTETIT
TIRANE
1987
3774

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ETJE QË SHUHEJ...

Ecnim mbi shpatin më të lartë të malit. Rrezet e diellit digjnin dhe, ngaqë ajri s'levizte, vapa ishte bërë e padurueshme. Ishte kohë korrjesh, por arat e vogla në faqet e kodrave dhe nëpër luginat kishin njëfarë shkretimi. Nëpër ajër ndihej era e shkumbit të fshatrave të djegura. Nga gërmadhat akoma dilte tym.

Jahoja ecte në krye të kolonës dhe herë-herë kthente kokën nga shokët, si të donte t'i nxiste të shpejtonin. Pranë iu afrua Neli, një djalosh nja njëzet vjeç, flokëkaçurrel e me fytyrë të mprehtë.

— Të hidhem për ndonjë pikë ujë te Burimi i Gurës? — tha duke e parë komandantin me sy lutes. Ai ishte prej atyre anëve dhe pikërisht për

këtë sikur e ndiente veten fajtor që s'po u gjente ujë shokëve.

— Mos na u largo shumë, — porositi Jahoja.

Hapat e Nelit u ndien tek kërcitnin në shtratin e thatë të një përroi. Përreth dëgjohej zhuzhima e gjinkallave, ndërsa nga gurët e nxehtë e të çarë nxirrnin kokat hardhucat që, sa dëgjonin zhurmë, fshiheshin menjëherë. S'ka ujë në këtë thatësi, jo! — tha me vete Jahoja. Shikimi i tij i shqetësuar rrëshqiti mbi kodra e male të zhveshura që në horizont dukeshin sikur puqeshin me qiellin. Batalioni i tyre, një natë më parë, kishte rënë në përpjekje me forca të shumta armike. Po bëheshin gati të çanin rrethimin, kur erdhi lajmi se armiku kishte zbuluar spitalin partizan në fshatin Bredh dhe kishte nisur për atje forca. Dhe skuadrës partizane iu ngarkua detyra të organizonte sa më shpejt tërheqjen e të plagosurve...

Dikush filloi të këndonte me një zë të ulët e të ngjirur. Pas pak kënga kaloi gojë më gojë. Buzët e tyre të zhuritura lëviznin ngadalë, por me ngulm. Tek i shihte, Jahos i hipi dëshira t'u jepte ujë të gjithëve, t'u lagte buzët e t'u freskonte fytyrat. Por ai e mundi atë tundim. «Duhet ta ruajmë për çastin më të vështirë, kemi akoma udhë dhe vendi duket i zhveshur», mendoi. Mbi shpinë ndiente tek tundej paguri i vetëm me ujë, punuar me dru bushi, që ai e ruante si një kujtim të çmuar. E kishte nga babai. Në trupin gjysmë të rrumbullakët të pagurit ishte gdhendur një shqiponjë. Ndërsa Jahoja vetë kishte shtuar mbi krerët e saj yllin me pesë cepa...

Që prapa një shkëmbi, nga e djathta e tyre, doli Neli. Djaloshi vështroi në sy Jahon, tundi kokën në shenjë mohimi dhe u bashkua me të tjerët. Mbi bluzat u shquheshin blana djerse. Hapat u rëndonin mbi gurishte dhe mbi degët e holla të kaçubave, që thyheshin me një kërcitje të thatë. Po zbritnin pllajën. Një kundërmim rigoni u shponte hundët. Aty-këtu shihej ndonjë prrall i vetmuar. Lena trupvogël, me bishtaleca të gjatë, shkëputej herë-herë nga kolona. E tërhiqnin trëndafilat e egër që, ndonëse të nxehtët dhe thatësira i kishte fishkur, ruanin akoma ngjyrën e kuqe. Ajo qëndroi të këpuste, por nuk i arriti dot, dhe ktheu sytë kërkues nga Çumani. Djaloshi vuri buzën në gaz: në pak çaste trupi i tij i shkurtër e i lidhur u gjend mbi shkëmb. Këputi tufën me trëndafila dhe ia zgjati. Vajza e pa me mirënjohje. Sytë i shkëlqenin. Pastaj diçka i erdhi në mend dhe ashtu e shpejtë, kaloi nga njëri te tjetri me nga një trëndafil. Më në fund, nuk i mbeti asnjë për vetë.

— Merre, Lenë, — tha Çumani, duke i zgjatur trëndafilin e vet. Ajo e mori dhe diçka sikur i lëvizti në bebëzat e syve. Jahoja e pa me vëmendje. Sepse e ndali shikimin te shenja e plagës përmbi njërin vetull. Iu kujtua ajo natë... Çumani, Lena dhe një shoqe partizane, gjatë zbulimit, kishin rënë në përpjekje me një kompani gjermane. Ndërsa çanin rrethimin, Çumani ishte plagosur rëndë. Ai digjej nga ethet dhe kërkonte ujë. Ishte një natë e bukur dhe e qetë. Yjet rrethonin hënën dhe vendi ndriçohej me dritë të kursyer. Lena u kujtua se diku afër, ku ishte zhvilluar përpjekja, rridh-

nin buronjat e fshatit. U nis për andej përmes pyllit. Kur arriti te buronjat, dëgjoi zëra në gjuhë të huaj. Ishin gjermanë që ruanin një depo të por-sangritur. Partizania iu afrua me kujdes burimit të parë. Futi duart në ujë dhe, tek ndjeu freskinë, i hipi etje të pinte. Kur filloi të mbushte pagurin, pa se një nga rojet gjermane po vinte aty. Hapi zjarr; duke qëlluar, filloi të tërhiqej. I shpëtoi rrethimit dhe arriti te shokët.

— Po ti qenke plagosur! — i tha shoqja, e prekur.

— S'është gjë, një gërvishtje, Shano. — Dhe nisi të lagte buzët e zhuritura të Çumanit...

«Përsëri uji m'u kujtua», tha me vete Jahoja dhe, duke mbledhur forcat, u përpoq të hidhte hap të sigurt. I bëhej sikur përreth rridhnin ujëra, ndërsa ata, çudi, kalonin duke ngritur poshtë këmbëve pluhur të nxehtë. Fërkoj qepallat dhe shikoi me bisht të syrit nga shokët. Ata ecnin në heshtje. Zallishta kërciste nën opinga. Në fund të pllajës shtriheshin fshatra të njohura, por ata s'mund të zbritnin atje. Ajo zonë ishte e pushtuar nga armiku. Neli kërkoi të kthehej në ndonjë fshat, por Jahoja s'pranoi, megjithëse i erdhi mirë për këmbënguljen e djaloshit. Njëherë, i kujtohej Jahos, të dy kaluan në një fshat, në shtëpinë e një plake. Kur ishin ngritur në mëngjes, plaka u kishte dhënë për shokët dy trasta me ushqime.

— Janë shumë, — i thanë ata.

— I keni nga fshati, bijo. Mbrëmë erdhën gratë e mëhallës e i prunë për ju. — Pastaj u kishte dhënë nga një copë bukë për vete, djathë e qepë, që t'i hanin rrugës.

Ndërsa largoheshin, ai kishte parë Nelin duke nxjerrë nga xhepi copën e bukës dhe duke e futur në trastën e shokëve...

Rrëzë një mali të lartë u shfaqën konturet e një fshati. Jahoja u përpoq të maste largësinë. Duhet dhe dy orë udhë, tha me vete. Në sy i lëvizte shqetësimi. Një grimë herë qëndruan e vështruan andej. Neli bëri me dorë nga mund t'i binin më shkurt. Dhe ata u vunë në udhë përsëri.

Pas pak një harabel i vogël u vërtit mbi kokat e tyre, u shkëput pingulthi dhe humbi në një kaçubë.

— Skifteri, — tha Neli me sytë nga qielli.

Shpendi grabitqar qëndronte krahëhapur në hapësirë; pas çdo rrethi që bënte, ulej gjithnjë, si të kishte zbuluar diku prenë e vet. Neli hoqi pushkën nga supi.

— Mos, djalo, zhurma do të dëgjohej... Kemi skifterë të tjerë përpara, — qeshi Jahoja.

Neli s'foli. Uli armën, pa i hequr sytë nga grabitqari, që humbi diku nëpër qiell... Vazhdonin të ecnin. Herë-herë dëgjohej zëri i ngjirur dhe hokatar i Fitimit. Ai ecte pranë Nelit.

— Neli, a do ketë kokrra ajo gorrice atje?

— Është prall.

— Mos më fyej, vëllaçko, nuk tregoj përralla unë! — qeshi Fitimi. Pastaj shtoi: — Thonë se, njëherë, një mbret...

Fitimi ishte djalë nga qyteti. E kishin përjashtuar nga shkolla tregtare se kishte sharë fashizmin. Kur doli në mal, me Nelin u bënë miq të ngushtë. Dhe e ndiznin miqësinë edhe me shaka, se nuk ia merrnin për keq njëri-tjetrit. Nën kë-

bët e tyre rrëshqitnin guriçka që binin me rrapëllimë në greminë. Dikush rrëshqiti. Jahoja ktheu kokën i shqetësuar. Ishte Kozmai, një djalosh rreth të shtatëmbëdhjetave, leshverdhë e me hundë të vockël. Pranë tij ecte Neli. E ndihmoi të ngrihej dhe, si i hodhi krahun, vazhduan rrugën. «Kemi akoma edhe goxha udhë, — tha me vete Jahoja. — A do të durojmë dot?» As Kozmai, që ishte më i këputuri, nuk po ankohej. Ai ishte djalë i vetëm. Ditën që erdhi partizan, i kujtohej Jahos, e shoqëronte e ëma, një plakë e mirë si të gjitha nënat. Në dorë mbante një boçe të madhe. Në fillim menduan se atje do të kishte ushqim e rroba për të birin, por nuk doli ashtu. Kur do të nise-shin, ajo kërkoi t'i puthte partizanët e çetës. Fuste dorën në boçe, nxirrte një grusht arra dhe ua jepte. «Njëlloj ju kam të gjithë, biro, si Kozmanë!» — u thoshte me zë të ulët, duke kaluar nga njëri te tjetri. Pastaj përqafoi të birin. «Ti je i ligur, djalë i nënës, por bëhu i fortë, do të jesh me shokë shumë, të më nderosh!» Jahos nuk i hiqej nga mendja figura e asaj plake trupvogël që në ato çaste, kushedi, mbase mendonte për të birin. U shkëput nga përfytyrimi dhe pa Kozmanë. «Epo do arrijmë në fshat, — tha. — Djemtë po digjen për ujë.» Ndaloj dhe iu kthye shokëve. U panë në sy. «E kush do të pijë më parë me një pagur», mendoi Jahoja. Një si hije shqetësimi i mbuloi fytyrën e përcëlluar nga dielli. Shkoi dorën mbi ballin e gjerë. Pastaj ashtu, ngadalë, nxori pagurin. Për disa çaste ra heshtje.

— Të pinë ata që kanë më shumë etje, — prishi heshtjen zëri i Nelit. Jahoja bëri me kokë.

Vështrimi i tij rrëshqiti mbi fytyrat e partizanëve e sytë i mbetën te Kozmai. Tek ndjeu vështrimin e komandantit, djaloshi bëri një përpjekje të mundimshme që të mos e jepte veten.

— Fillo, ti, Kozma, — tha Jahoja.

— E pse unë, shoku komandant? — u druajt djali.

— Pi, pi, Kozma, — u dëgjuan zëra.

Me duart që i dridheshin lehtë dhe me shikimin nga shokët djaloshi mori pagurin dhe e vuri në buzë. Një pikë ujë i ra në mjekër.

— Pi, — tha me zë urdhërues Jahoja, kur kuptoi që partizani vetëm sa njomi buzët e zhuritura. Djaloshi ngriti përsëri pagurin dhe e mbajti pak më gjatë se në fillim. Sapo iu njom qiellza, iu ndez etja më tepër. Gurmazi i zhuritur kërkonte ujë, ujë... E hoqi gati me forcë nga buzët, duke mposhtur atë dëshirë të papërmbajtur dhe ia zgjati pagurin Lenës.

— Pi, Lenë, — tha Jahoja.

— Ja, po pi, shoku komandant. — Ajo mbështeti pagurin në buzë. Pastaj ia kaloi shoqes pranë.

— Unë, — murmuriti Vera, — unë...

— Pi, — u dëgjua një zë. Ishte Jahoja. Mëgjithatë, pa rënë në sy, ai bënte llogari me mendje se për sa njerëz akoma do të arrinte uji.

Paguri kalonte dorë më dorë. Jahoja shihte fytyrat e tyre të rreshkura. Paguri ndodhej në duart e Fitimit. Ai e mbajti një çast në buzë e ia kaloi Nelit. Neli pastaj ia zgjati Jahos.

— Merre prapë, Neli!

— Pini, shoku komandant, — tha gati me ton lutës djaloshi.

— Merre, Neli. — Në zërin urdhërues të komandantit u ndie një dridhje e lehtë. Neli e mbajti dhe një çast në buzë dhe ia zgjati prapë. I bindur se ajo nuk do të kishte më ujë, Jahoja u mat ta fuste në çantë. Por... Në pagur u ndie lloçitja e ujit. Iu drodhën duart, e tundi. Aty kishte mbetur gati gjysma.

— Pini dhe ju, shoku komandant, — sekush foli nga vajzat.

— E, de, e! — ia bëri Jahoja.

Ai mbështëti një çast pagurin në buzët e thara, por... çudi, sikur nuk po ndiente më etje.

Vazhduan udhën. Dukeshin më të freskët, sikur t'ua kishte hequr njeri me dorë etjen dhe lodhjen. Edhe Kozmai ecte pa ndihmën e shoqëve. Kurse Fitimi vazhdonte me shakatë e veta.

Përballë një kodre u shfaq fshati Bredh.

B A S H K Ë

Ishte ende herët, kur Kola doli në rrugë. Mbushi kraharorin me ajrin e pastër dhe hodhi me kënaqësi vështrimin rreth e qark. Mjegulla e lehtë e agut davaritej ngadalë dhe përtej shquheshin gjithnjë e më qartë konturet e kodrave. Andej ishte kántieri i madh ku ngrihej uzina.

Ai nisi të ecte me nxitim. Në të dalë të qytetit, përballë një pallati që ngrihej ndanë rrugës, ngadalësoi hapat dhe ngriti një çast sytë e pa nga dritarja. Në qiellin që zbardhej po shuheshin yjet e fundit. «Fle», tha me vete dhe një valë e nxehtë e përshkoi të tërin. Atij i erdhën në mendje fytyra e saj e lëmuar dhe sytë disi të vegjël, që për shkak të kthjelltësisë dukeshin si të larë

me dritë. Ajo... Një buçimë e shkurtër që erdhi nga kantieri e bëri të nxitonte. Do të jetë Lenoja, mendoi. Kapërceu disa tuba, një kanal kabllosh dhe u gjend pranë një vinçi të madh që ngrihej midis objekteve. Përreth ishin shpërndarë konstruksione e pajisje metalike, ndërsa pak më tej ngrihej rreshti i gjatë i rezervuarëve që kishin përfunduar.

— Mirëmëngjes, o Leno! — thirri duke ngritur sytë lart nga kabina. Vinçieri ishte një burrë i paktë nga trupi, rreth të dyzetave.

— Mirëmëngjesi, Kolë!

— Paske ardhur herët!

Tjetri nuk iu përgjigj, por vazhdoi të merrej me diçka atje sipër. Kola e pa dhe një çast dhe u afrua pranë derikut¹⁾ të madh. Kontrollloi kavot një copë herë. Pastaj, kur u sigurua se gjithçka ishte në rregull, u ul mbi një gur dhe ra në mendime. Brigada që drejtonte do të kryente atë mëngjes një nga punët e vështira të montatorëve. Do të ngrinin derikun e madh metalik. Me ngritjen e tij fillonte montimi i objekteve të larta, karakteristikë për atë uzinë, ose, siç thoshte Kola, do të fillonte puna e vërtetë e montatorit. Pastaj do të ngrinin derikë të tjerë dhe uzina do të merrte formë pak nga pak...

Nga larg erdhën zëra dhe të qeshura. Një natë më parë kishin vendosur që ngritjen e derikut ta fillonin kur të zbardhte mirë. Por, me sa dukej, secili diçka kishte bluar dhe ishte nisur me mendimin të arrinte i pari në kantier.

1) Kullë e fuqishme vinçi me lartësi deri 60 metra.

Doli dielli dhe çdo gjë përreth u qartësua. Një grup dallëndyshesh erdhën papritur: në atë ajër të lehtë e të përndritur, cicërimat e tyre sepse u ndien të gëzueshme. Montatorët u shpërndanë në frontin e punës. Kavot e trasha të vinçit u tendosën dhe maja e derikut nisi të shkëputej ngadalë nga sipërfaqja e tokës, duke përhapur përreth një re të lehtë pluhuri.

— Kujdes, më majtas! — dëgjohej, përmes zhurmës, zëri i qetë i inxhinierit që drejtonte ngritjen.

Kola kishte përqendruar vështrimin në lëvizjen e krahut të hekurt dhe, herë-herë, i buzëqeshte Leno vinçierit. Kishin vjet që njiheshin dhe atij të gjithë i thërritnin ashtu, Leno Vinçieri.

Kavot tendoseshin dhe maja e derikut ngrihej gjithnjë e më lart. Kur ngjitja ndërpritej, gjithë ajo peshë e rëndë dukej sikur rrinte pezull në hapësirë. Kola nuk e ndante vështrimin andej. Befas, atij iu bë se deriku u drodh. Vuri re se edhe dallëndyshet u shpërndanë në drejtime të ndryshme dhe morën lartësinë. Pastaj dikush thirri:

— Kavoja, kavoja po rrëshqet!

Brenda një çasti gjithçka përreth sikur u elektrizua. Vinçieri ndaloi ngritjen. Montatorët, të shtangur, mbërthyen vështrimet anash majës së derikut. Diçka e papritur kishte ndodhur. Spinoti në trupin e derikut, ku lidhej kavoja e vinçit, ishte këputur në njërën anë dhe kavoja po rrëshqiste ngadalë. Ajo lëshonte gërvimë, sa herë fërkohej pas spinotit.

— Largohuni, asnjë poshtë derikut. — prishi

heshtjen zëri i tronditur i inxhinierit. — Leno, zbrit mengadalë!

Kola shihte i ngurosur. Vetullat e holla e të zeza i dridheshin lehtë dhe, ngaqë kishte lidhur duart përpara, dukej sikur nuk u besonte syve: si ishte e mundur të ndërronte gjendja aq papritur?

Deriku lëkundej lehtas, sikur kërcënonte me hijen e tij të rëndë grumbullin e rezervuarëve. Krahu i vinçit, që e mbante në lartësi, dridhej herë-herë, ndërsa Lenoja atje sipër përpigëj të manovronte. «Po ky ç'bën, përse nuk zbret?» pyeti veten Kola. Po në çast e kuptoi se largimi i Lenos nga kabina e vinçit do të thoshte që edhe rezervuarët, edhe deriku t'i liheshin mëshirës së fatit. Hodhi një vështrim të shqetësuar rreth e qark. Inxhinieri, i bërë qull në djersë, jepte e merrte, ndërsa shokët lëviznin dhe përpiqeshin të bënin diçka për të mënjanuar rrezikun. Lëvizi edhe ai një grimë. Pastaj, si t'i kishte gjetur ilaçin, rrëmbeu një kavo metalike që iu ndodh pranë dhe vrapoi drejt vinçit.

— Kolë, ku shkon? — Inxhinieri dhe disa montatorë deshën ta mbanin, po ndërkaq ai kishte kërcyer mbi vinç dhe po i ngjitej krahut të tij të lartë. Nga poshtë i vinin zëra përgjysmë:

— Të mos hipë njeri tjetër, shokë! Lëkundjet... Duhet kështu!...

— Jo po...

— Të afrojmë... vinç...

— Si?!

Zërat i dëgjonte gjithnjë e më mbyturazi, sepse vazhdonte ngritjen pa ia ndarë sytë kave


që rrëshqiste. Edhe dielli ishte ngjitur dhe rrezet e tij nisën të digjnin. Kola kishte arritur te mesi i krahut të vinçit dhe tani përparonte më ngadalë. Çdo lëvizje e tij kishte njëfarë tendosjeje. Kurse mendja i rrihte në një pikë: të arrinte në kohë te kavoja. Kjo thirrje e brendshme sikur i oshëtinte në veshë. Befas, sytë i ndritën... Kavoja ndali rrëshiqitjen dhe atij iu duk se shokët atje poshtë psherëtinë thellë. Për disa çaste qëndroi pa lëvizur dhe mbajti frymën. Dëgjohej vetëm zhurma monotone e lumit, përtej bregut, fëshfëritja e erës dhe ciatjet e shkurtra të dallëndysheve në fluturim. I shfrytëzoi ato pak çaste dhe u përpoq të përqendrohej. Në fillim kishte vepëruar pa u menduar gjatë, por tani që iu dha mundësia ta shihte më me gjakftohtësi defektin, sikur arriti ta krijonte më mirë idenë e mënjanimit të rrezikut. Me kavon që mbante në dorë do të përçafonte trupin e derikut, pastaj do ta lidhte atë me kavon e vinçit. Vazhdoi ngjitjen. Një dallëndyshe i kaloi përkitazi me kavon. Një pranverë, kur ishte ende nxënë, ai kishte shkruar në hartim se ka diçka të përbashkët midis montatorëve dhe dallëndysheve, ata shtegtojnë nga një vend në tjetrin dhe i duan lartësitë. Edhe Kola i donte lartësitë që i vogël; ashtu, me pantallona të shkurtra e këmbët tërë baltë, ai ngjitej në majat më të larta të pemëve; atje midis gjetheve të dendura dhe fishkëllente si zog, duke i befasuar shokët që e kërkonin... Por tani ai ishte bërë burrë dhe krahasimi i lehtë me dallëndyshet kishte mbetur me fëmijërinë... Edhe pak dhe do të arrinte te trupi i derikut. E përqendroi shikimin te spinoti

dhe ngjiti një shkallëz tjetër. Krahu i hekurt e përcolli lëkundjen. Kavoja lëshoi gërvimën karakteristike dhe u ndal përsëri. Tani ai e kishte të gartë se çdo lëvizje e tij do të shkaktonte rrëshqitjen e kavos, prandaj mati me sy largësinë. Duhej të ngjitej edhe më në trupin e derikut. A do të arrinte vallë në kohë? Po sikur... Për herë të parë gjatë atyre çasteve po dyshonte dhe mbeti në mëdyshje. Pastaj uli sytë poshtë dhe pa nga shokët. Ata për diçka bisedonin dhe dukej se kërkonin të merreshin vesh. Njëri prej tyre u shkëput me vrull nga grupi dhe bëri drejt vinçit. Stefani! Sa nuk thirri nga gëzimi. Stefani, shoku i tij. E ku nuk kishin punuar bashkë! Edhe në Vaun e Dejës, edhe në Azotec, edhe aty mbi...

Por nuk kishte kohë. Ngjiti një shkallë tjetër. Kavoja rrëshqiti përsëri, deriku dhe krahu i vinçit lëvizën. «Mos u ngjit më. Kolë, do të rrezikohesh!» — iu bë sikur i foli një zë. Qëndroi dhe rrotulloi sytë ngadalë. U përpoq ta zbante atë zë dhe ruajti gjakftohtësinë. Një rreze dielli ia lëbyri sytë. Ai vuri dorën si strehë mbi ballë dhe ndjeu se ajo iu lag e tëra. «Hë, Kolë, u stepe ë?!» Ai i foli vetes aty për aty. Sytë i mbetën një çast te kabina e vinçierit, ku Lenoja, duke shtrembëruar fytyrën, shtrëngonte fort levat e manovrimit. Iu duk sikur vinçieri po i buzëqeshte, sytë e tij të butë e shikonin me dashuri e shqetësim. Diçka e brendshme e detyroi të lëvizte përsëri. Ngjiti edhe një shkallëz. Tani ishte pranë trupit të derikut. Pa edhe një çast të vetëm nga shokët, si të donte të merrte prej tyre diçka të papërcaktuar, pastaj hodhi me kujdes njëren dorë, hodhi

edhe tjetrën. Tani, çuditërisht, sikur ndihej më i qetë. Deriku lëvizi. Ai qeshi me vete: «Hë, qerrata derik, të kapa e s'të lëshoj më. Ti nuk do të biesh, mor i dashur. Hajt, bëhu i bindur tani. Ti do të ngresh përsëri kon.. struk... sione.» Kishte folur në lëvizje. Vendosi ngadalë edhe këmbën. Trupi iu shkëput i tëri nga krahu i vinçit dhe ai qëndroi mbi derik. Shihte qiellin e kaltër, diellin që i shfaqej si një disk i dridhshëm. Tani i duhej të lëvizte mbi derik. «Mbaroi kjo punë, Kolë, mbaroi!» sepe i tha vetes. Dhe pas kësaj u vu në lëvizje përsëri. Herë-herë hidhte shkarazi vështrimin poshtë. Gjithçka shihej si në pëllëmbë të dorës. Shokët, të shqetësuar, lëviznin në drejtime të ndryshme, disa duke u përpjekur të fiksonin kavot, ndërsa të tjerë afronin me ngut një vinç. Midis tyre dhe... Po. Ajo ishte! Që lart dallohej trikoja e saj ngjyrë vishnjë. Një rrëqethje e ëmbël i kaloi në trup dhe ai u përpoq të përfytyronte shprehjen e fytyrës së saj në ato çaste. Dëshironte që ajo të ishte krenare për të, ta shikonte me guxim e besim çdo veprim të tij. Ai dinte ç'bënte.

Një zhurmë që ndjeu poshtë këmbëve e detyroi të ulte sytë. Ishte Stefani. E pa me mirënjohje të thellë fytyrën e rrumbullakët, të djersitur e të rrahur nga dielli, të shokut që e kishte ndjekur në heshtje hap pas hapi. E ndjeu se të gjithë ata, si të ishin një trup i vetëm, jetonin të njëjtën gjë. Gjithnjë kështu kishin qenë. Si një familje, shtegtonin nga njëri kantier në tjetrin dhe shqetësoheshin e gëzoheshin së bashku. Kur pa që Stefani po bëhej gati të kalonte nga krahu i vinçit te deriku, vetëtimthi i lindi një mendim. Donte t'i



thoshte Stefanit të zbriste, përse të rrezikonte edhe ai, por e mbajti veten.

Asgjë nuk do të ndodhte. Ata do të ndërtonin vepra të tjera. Ai kishte parë kaç herë maketin e uzinës. Ajo ishte e madhe dhe ata ishin në fillim të objekteve. Më të rëndësishmet do t'i ngrinin tani. Kola përfshiu me një vështrim hapësirën përreth. Ja, aty ku ishin shokët, do të ndërtoheshin furrat dhe kullat e koksit, pak më tej, tek ato kaçubat, estekadat, pastaj krekingu katalitik... Në përfytyrimin e tij shihte uzinën, që do të inaugurohej një ditë.

— Më liro vend, Kolë. — Ishte përsëri zëri i Stefanit. Tani të dy ishin fare pranë dhe ndienin frymëmarrjen e rënduar të njëri-tjetrit. Tashmë ishte vendosur: Stefani nuk do të ndahej nga shoku. Ky ishte urdhri i ndërgjegjes së tij.

Vazhdoi të lëvizte mbi derik dhe pak çaste më vonë ndjeu përsëri një lëkundje të lehtë.

Stefani kishte hipur. Ktheu kokën ngadalë dhe i buzëqeshi shokut: «Jemi vëllezër, mor Stefan», thoshin sytë e tij. Bënin lëvizje të matura e të vetëdijshëm për rrezikun. Edhe pak dhe u afruan te spinoti, puna më e vështirë e që kërkonte kujdes të veçantë. Përsëri një lëkundje e lehtë. Ata shihnin pranë, fare pranë, kavon që ishte afruar në buzë të spinotit. Gjakftohtësia është gjithçka në të tilla raste dhe ata e dinin këtë. Kapën fort kavon metalike dhe nisën të përqaftnin me të trupin e derikut. Vepronin pa folur dhe herë-herë sikur «grindeshin» pa fjalë. Në «grindjet» e tyre kishte diçka nga dashuria për shokun. Secili donte të bënte vetë punën më të rrezikshme. Të dy kapën fort

kavon për herë të fundit dhe e lidhën me ganxhën e vitit.

— Kolë!

— Stefan, e hodhëm, më duket. Ej, Leno Vinçieri, bëhu gati në drekë për një dopio raki, — qeshi Kola.

Duke u mbajtur me njërin krah te trupi i derikut, u përpoqën ta toknin dorën tjetër me shoku-shokun. Nga kabina Lenoja nxori gjysmën e trupit.

— Mbahuni, mor, se pastaj ka rrezik të na e pinë rakinë të tjerët, — ia ktheu shakanë Kolës.

Pas kësaj thirrjeje u ndie një lëkundje më e madhe dhe kavoja rrëshqiti përsëri. Zhurma e saj çjerrëse tani i ngjante agonisë së një gjarpri të jashtëzakonshëm që ishte mposhtur.

Kur i tokën duart, Kola besoi se ndiente të rrahurat e zemrës së shokut. Çudi, rrihte shpejt e me të njëjtin ritëm. Sytë i ndritnin dhe çdo gjë përreth i dukej si në ëndërr. Në vesh i gjëmonin zëra të gëzuar.

— Shiko, Stefan, sa qenkan mbledhur! Tërë kantieri është aty!

Midis tyre ata dalluan shokët e brigadës dhe inxhinierin që kruante zverkum sikur sapo të kishite hequr nga supet një barrë të rëndë. Stefani buzëqeshi, ndërsa Kola kërkonte të shquante midis grumbullit të njerëzve atë trikon ngjyrë vish-një... Po dielli ia merrte sytë.

NATA ME SHI

Maksi shtriu disa herë me kënaqësi krahët dhe, si kërcëu nga shtrati, filloi të vishej duke fish-këllyer. Nga dritarja gjysmë e hapur hynte një korent ajri i freskët dhe jashtë koha dukej e bukur. Ai ishte piktor amator, por punimet e tij s'para pëlqeheshin. Zakonisht për to thuhej vetëm kaq: «s'kanë jetë». Në fillim ai mendonte se të tjerët nuk e kuptonin, por, kur qetësohej, përpiqej të hetonte se çfarë u mungonte pikturave të tij. Ndodhte që, i lodhur, flakte penelin, si t'ia kishte fajin ai dhe shikonte i mërzitur punën e vendosur në kavalet. Dikush i tha se ndoshta kishte nevojë për vëzhgime të drejtpërdrejta në jetë dhe se do të ishte mirë që lejen e krijimtarisë ta bënte në një kan-

tier pune. Ai u nis në një kantier ndërtimi të hekurudhës.

Po bëheshin dhjetë ditë që kishte ardhur dhe koha po e ndihmonte. Ashtu siç donte ai. Dhe kishte bërë goxha punë. Gati një faqe dhomë e zinin vizatimet dhe akuarelet nga natyra. Sa herë vinin shokët e dhomës (ata ishin tre djem, ndërtues në një urë të madhe), shikonin vizatime të reja. Ata i soditnin dhe largoheshin pa thënë ndonjë fjalë. Një natë më parë, kur Maksi i kishte pyetur nëse kishin ndonjë vërejtje, Seloja, që ishte ca më i madh nga të tjerët, i tha:

— Pse s'vjen të pikturosh atje ku punojmë ne?

Piktori ndjeu se në ato fjalë fshihej diçka më tepër dhe i dogji.

— Këto s'ju pëlqejnë? — pyeti.

— Atje mund të bësh diçka më të bukur, — tha tjetri. Maksi s'e dha veten dhe bëri buzën në gaz.

Të nesërmen e ndau: do të vente nga ura. Ditë që prapë e bukur dhe mendoi se koha ishte e përshtatshme sidomos për peizazh.

Epo kam kohë, e qetësoi veten, shkoj ndonjëherë tjetër tek ura.

Pasi rrëmbeu kavaletin, doli jashtë. U gjend mbi një ledh të lartë, nga shihej një faqe kodre me fletët e hurmave që po skuqeshin.

Në mëngjesin e ditës tjetër u zgjua nga një zhurmë shurdhuese. Binte shi i rrëmbyeshëm dhe rropama e tij shumëfishohej mbi çatinë prej eterniti. Djemtë u ngritën dhe filluan të visheshin.

— Eh, djalli! — mallkoi Ganiu. — Po dhe ne, si s'e dëgjuaam më parë!?

— Vërtet që masat janë marrë, por, kur bie

shi, lumi egërsohet dhe ka rrezik të dalë nga shtrati. Është halli i motopompave, — tha Pertefi.

Dëgjohej fëshfërima e mushamave si një fërkim gishtërinjsh.

— Njëri nga ne të shkojë te Brahoja. Rrëketë e malit mund të përmbytin themelet e murit mbrojtës. Duhet të hapet një kanal sipër, — foli Seloja.

— Mbaj unë andej dhe takohemi te prita.

— Aty takohemi, Pertef.

U dëgjua kërcitja e derës dhe ata dolën. Maksi i hodhi një sy orës, akrepat po i afroreshin treshit. Përmes dritares ai dalloi turbull siluetat e njerëzve që shpërndaheshin jashtë.

Në mbrëmje djemtë u kthyen në dhomë. Maksi kishte kaluar një ditë të mërzitshme. E kishte mundur sidomos vetmia. Dy-tri herë deshi të dilte të shkonte diku, të bënte diçka me të tjerët. Po shiu nuk kishte të sosur dhe atë sikur e mbante frika e një pleviti të vjetër që kishte marrë dy vjet të shkuar.

— Hë, si e kaluat? — s'iu durua atij sapo u kthyen djemtë.

— Ahaaa, sot e patëm pisk! — tha Seloja.

— Mirë që erdhën vullnetarët! — tha Ganiu. — Nuk e pe, sikur ta shtynte dikush me dorë, uji gërr e gërr rrëshqiste drejt e te muri mbajtës. Gjergji, si e quanin atë djalin, ia zuri frymën shpejt me armaturat. Ndryshe... Pah, çfarë djali ishte!

Pak nga pak biseda u gjallërua dhe dukej sikur tani kishin dëshirë të flitej për atë që s'kishin pasur kohë të flitnin gjatë ditës.

— Ishin përmbytur dy plinte, — tregoi Pertefi, — dhe brenda kishin mbetur motopompat. Por më

e keqja ishte se uji vazhdonte të vinte dhe ata rrezik të dëmtoheshin.

— Po si i nxorët? — pyeti Maksi.

— U fut Seloja, — tha Pertefi. — Hajde, Selo kokedashi, hajde!

— Seloja? — mërmëriti Maksi. — Po ti, Selo, nuk ke pasur ndonjëherë plevit?... Apo, ç'them edhe unë! — u ngatërrua me vete. Kushedi përse i vajtën sytë te vizatimet e varura në muret e dhomës. Aty kishte kodrina, gjethe, dritë, zogj... po shokët e tij të dhomës mungonin. Ata po qeshnin tani me zë kumbues dhe ai ktheu kokën. Biseda, me sa dukej, kishte ndërruar. Pertefi ishte skuqur i tëri dhe ankohej duke lëvizur duart, sikur të mos dinte ku t'i fuste.

— Pse s'na tregon? — thoshte Seloja.

— Nga ne e mban sekret, a derëbardhë! — e ngacmoi edhe Ganiu.

— Jo, s'kam sekret, — u përpoq të shfajësohej Pertefi.

— Po letrën që more sot? — Ganiu i shkeli syrin Selos, — Hë tani, kur do ta tundim?

— E shikon këtë, që bëhet si speci i kuq kur flet? Ja, këtë, që duket sikur s'ia mbush syrin njeriu! Bëri ç'bëri, rrufjani, dhe e ujdisi me një vajzë të turnit të kaluar. Ka të ngjarë që tani shpejt ta humbasim mendjen nga rakia në dasmën e tij! — tha Seloja duke u drejtuar nga Maksi.

— Dhe rrinte si pulë, pale! — e përqeshi Ganiu. — S'ndihej fare, levendi. Dhe e kisha parë nja dy herë, seç i thoshte, kur vallëzonin, por...

Maksi dëgjonte me dashamirësi. Atij i kujtohej Moza, që e kishte njohur dikur në aksion, fy-

tyra e saj vezake, me sytë blu të çelët, që lëviznin me çapkënllek, flokët e gjatë e të lëshuar që ajo s'donte t'i priste. «S'më lë gjyshja», thoshte. Ç'bën tani? pyeti veten. Ndoshta u tregon shoqëve ndonjë nga pikturat e mia... Shpesh edhe ajo nuk tregohej entuziaste për punët e tij... Kur mendoi këtë, i erdhi hidhur.

Për disa ditë koha nuk po mernte më për mirë. Mbante vrenjtur dhe binin rrebeshe shiu. Maksi ndihej i shqetësuar dhe nervoz. S'dinte ç'të bënte dhe s'u jepte dot rrugë mendimeve. Duke e parë kështu të mërzhitur, Seloja një ditë i tha:

— Hajde me ne tek ura!

Të nesërmen, herët në mëngjes, kur ata u ngritën për punë, e zgjuan edhe Maksin.

— Çfarë? — ia bëri përgjumësh.

— Nuk do të vish tek ura? — e kujtoi Seloja. Maksit i erdhi zor; pa ç'pa dhe u ngrit.

Ura ishte vërtet e madhe. Poshtë nuk rridhte më ai uji i kaltër që kishte pikturuar në një nga peizazhet, në një ditë me diell, por një lumë i egërsuar vinte me vorbulla të mëdha. Shkumëzohej turbull e dukej sikur përpinte gjithçka që gjente përpara. Qielli anekënd ishte nxirë dhe, herë-herë, ndriçohej nga vetëtimat.

Ishte koha kur niste punën ndërresa e tretë. Maksi ndenji një grimë herë pa ditur ç'të bënte. Dhe në përgjithësi mendoi që zor se mund të bënte diçka aty në atë mot me shi. Prandaj i erdhi mirë kur dëgjoji Selon:

— I shikon ato dërrasat atje? Duhet grumbulluar te ledhi.

Maksi filloi t'i ngrinte duke i kapur me kuj-

des. Po ishin të rënda dhe mezi i tërhiqte zvarrë. Uji po i depërtonte nën mushama. Një çast ndjeu t'i kalonin në trup mornica dhe i erdhi në mendje ai pleviti...

— Siç e ke zënë ti, s'ke gjë në vijë! — i foli dikush. Ishte një djalosh më i ri nga ai që bënte të njëjtën punë.

Maksit i erdhi rëndë dhe, duke mbledhur forcat, e ngriti dërrasën më lart. Kaloi një orë dhe ai kishte dëshirë të ulej diku.

Po ku? Aty s'kishte asnjë mbrojtje. Vetëm tej ishte një barakë e vogël për veglat. Të shkonte atje? Ndërsa kishte humbur vështrimin andej, u duk një kamion i rëndë, ngarkuar me zhavorr. Makina ndaloi përpara urës. Shoferi, një burrë rreth të pesëdhjetave, rrëmbeu një lopatë dhe filloi të shkarkonte. Mbi makinë hipi dhe djaloshi që punonte me të. Pas një grime, shoferi, që as e njihnte dhe as e kishte parë ndonjëherë Maksin, i thirri: «More, nuk i ke sytë në ballë ti atje! Hë, ç'pret akoma? Hadje, zotrote, se ka lopatë dhe për ty... More, e vënë ca firmën në bordero, more....», — turfullloi shoferi me vete. Maksit i erdhi t'ia kthente rëndë, pastaj u afrua të sqarohej, po ai tjetri i zgjati një lopatë duke turfulluar përsëri: «Hajde, mor babam, hajde! Lumi nuk pyet as për ty dhe as për mua!».

Kur iku makina dhe ata vazhduan të mbartnin dërrasa, shiu zuri me rrëmbim.

— Shpejt, më shpejt! — foli djaloshi, i cili nuk e hiqte vështrimin nga lumi që sa vinte e fryhej. Njerëzit kishin njëfarë ngutjeje... Pastaj djaloshi i futi krahun dhe të dy ecën drejt barakës së vogël.

Si u ulën në një stol, ai nxori një pako të mbësh-tjellë. E pa se tjetri nuk kishte marrë gjë me ve-te.

— Hajde të hamë, — i tha.

Maksi bëri sikur s'donte, po, kur djaloshi i lë-shoi në dorë një rriskë bukë me sallam, filloi të përtypej në heshtje.

— Kë ardhur me punë fizike?

— Jo, me leje krijimtarie. Jam piktor, — tha Maksi.

— Piktor?! — përsëriti tjetri i habitur. — Po pse s'flet, mor vëlla, unë u hoqa sikur çoç jam kë-tu e të komandoja si të ishim në një brigadë... Dreq, o piktor, ç'paskam bërë! — qeshi, duke përplasur pëllëmbët në kofshë. Ai ishte qullur nga shiu dhe streha e kasketës ende i pikonte.

— Epo, të më falësh, pra!

Maksit sepse i pëlqeu ai njeri dhe ngriti su-pet:

— E përse të të fal? Sos më bëre ndonjë të keqe. Po ti nga je? — e pyeti.

— Nga Vlora. Vlora jonë - qytet i bukur, — qe-shi djali prapë. — Në këtë sektor kam punuar dy muaj si aksionist. Puna më pëlqen dhe, ja kështu, ia bëra si dhëndri kollovar, mbeta këtu si punëtor.

Maksi vazhdonte të përtypej. Tek ura kishte plot njerëz dhe atij se si i shkrepri të dinte nëse ky djalosh që kishte pranë njihej me Selon. Mbase nuk njiheshin, por Maksi mendoi se ata dy njerëz seç kishin diçka të përbashkët, që ai... U shkund, kur ndjeu mbi sup dorën e tjetrit.

— E shikon, po të mos... — Ai po tregonte me dorë nga lumi, që kishte kapërcyer shtratin dhe po

derdhej mbi vendin ku më parë ishte grumbulli i dërrasave.

— Ja që e bëmë në kohë. Thonë mirë, që çdo gjë duhet bërë në kohën e vet, mor piktor!

Të nesërmen dhe disa ditë më pas Maksi shkoi prapë me shokët tek ura. Me vete merrte edhe kavaletin e vogël dhe, sa dilte pak dielli, fillonte të punonte. Po zakonisht punët i ngeleshin përgjysmë, ngaqë kohaishte e paqëndrueshme. Atëherë shokët i thoshin me shaka se shiun e kishte sjellë ai. Maksi u buzëqeshte. Po ajo puna e shiut kishte filluar ta mërziste vërtet.

— Sikur nuk je mirë, — i tha një mbrëmje Se-loja, kur u mblodhën në dhomë.

— Qesh ti, qesh, po unë ngela pa punuar, ama! — u ankua Maksi. — Një shi si ky... Po kur do të hapet koha, xhanëm, kur do të punoj unë?! — Në tonin e tij disi të hidhur ndihej një notë shqetësimi e nervozizmi.

— Po edhe nesër mund të punosh, — tha në mëdyshje Ganiu. — Ti e di më mirë, por... Si të të them unë? Moti i keq, sigurisht, sjell vështirësi, por, bie apo nuk bie shi, ura do ndërtuar. Dhe, përderisa njerëzit e bëjnë punën e tyre, s'ke përse të mos e bësh edhe ti punën tëndë. Apo nuk hyn shiu në pikturë? — qeshi ai.

— Po kështu, kështu... — Maksi deshi t'i thoshte se tabloja dilte e zymtë, por sepse heshti. Dhe në heshtje, pak nga pak, iu përfytyrua ajo nata kur vetëtimat, që shoqëroheshin nga bubullimat e shumta, s'kishin të pushuar, kur lumi, i trubullt, dukej sikur do të përpinte gjithçka dhe siluetat e njerëzve merrnin ngjyra nën harqet e rrufeve që llapsnin

me dritë të fortë. Njerëzit, punëtorët, vullnetarët, shokët, që tashmë ai kishte filluar t'i njihte nga afër... More, more, mërmëriti sikur po i thërriste vetvetes për diçka, përse të mos bëj një tablo për natën e shiut?!

Skicoi deri vonë dhë, duke hedhur në letër skicidenë e tablosë së ardhshme, i lindi një dëshirë e beftë që, mundësisht, shiu dhe vetëtimat të vazhdonin natën.

Të nesërmen e ngriti kavaletin nën strehën e barakës së magazinës. Ura e pambaruar... poshtë lumi me vorbullat e veta, rrjeta e lëvizshme e shiut dhe ata, që pothuajse kishin munguar në peizazhet e tij... «Sa e vështirë është të shkruash me penel jetën e njerëzve që nuk i njeh nga afër», i kujtuan fjalët e një piktori të moshuar. Tani pikërisht ata njerëz ai i kishte bërë shokë.

— Ej, Maks! — i thirri dikush nga ura. Ngriti kokën dhe pa Selon që po ia bënte me dorë. — Se ku e lashë kapuçin e mushamasë diku aty... Shih njëherë mos është te dritarja.

Pas pak filloi të dëgjohej zhurma e makinës së betonit.

DHURATA

- Të dhemb krahun? — pyeti vajza.
- Jo, pak, — u përgjigj partizania.
- Do të rrish te ne?
- Nesër do të shkojmë.
- Po rri edhe ca ditë. Nëna do të ta shërojë fare krahun.
- Duhet të shkoj, Besa. Shokët më presin. Vajza psherëtiu.
- Ç'ke?
- Kam edhe unë dëshirë të vij me ju, po nuk më lënë. Je e vogël, më thonë. E pse jam e vogël? Pastaj, thonë se ka edhe pushkë të shkurtra...

— Po lufta nuk bëhet vetëm me pushkë, Besa, edhe këtu mund të luftosh.

— Kështu më thoshte edhe Halimi. Po prapë, ndryshe është sikur të vij në mal.

Partizania i lëmoi flokët. Ashtu, pranë e pranë, i gjeti edhe nënë Hasimeja.

— Ah, bijat e nënës!

I ngriti krahun partizanes dhe e pa në fytyrë.

— Do të të djegë pak...

— Do përpiqem ta duroj, nënë

— Me këtë ilaç për disa ditë do të shërohesh.

Partizania buzëqeshi dhe Hasimeja... Ah, sikur... Edhe ai ishte djalë i ri, i freskët, i bukur, si kjo nuse, nuse për... Sa dëshirë kishte të përmendte fjalën «nuse». Sa bukur tingëllonte, sidomos këtu, në shtëpi... Një lot i fshehtë iu bë sumbull në sy.

— Ç'ke, nënë?

— Asgjë, moj nusja e nënës, asgjë... Po edhe u plaka tani e nuk i mbaj dot lotët.

— Mbahu, nënë. Do të vij në ditë të mira e do të kesh gëzime.

Dhe partizania nisi t'u tregonte për luftën, për zonat e çliruara. U foli edhe për Halimin. Kishin qenë bashkë në një kompani. Nënë e bijë e shihnin në dritë të syrit. Partizania tregonte për çastet e fundit të jetës së Halimit. Ishte zvarritur bashkë me një shok për të asgjësuar një mitraloz të gjermanit. Mitralozin e asgjësuan, por shoku ishte plagosur. Atëherë Halimi e kishte vënë në sup. Për pak

e do të ishte tërhequr, po një plumb e kishte marrë për vdekje. Partizani tjetër kishte mbështetur kokën te shoku i vrarë dhe dukej sikur të dy i kishin mbyllur sytë duke menduar për njëri-tjetrin...

Kishte kaluar mesi i natës, kur ranë në shtroja. Nënë Hasimeja bubrroi edhe një copë herë në për dhomë dhe përgatiti dy boça të vogla për partizanen. Pastaj shoi kandilin dhe dhoma ra në errësirë. Vetëm tek oxhaku skuqte ndonjë thëngjill i pambuluar dhe, herë-herë, dëgjohej ndonjë kërcitje e lehtë.

Besa gjeti nën velenxë dorën e partizanes dhe ndjeu ngrohtësinë e saj. I bëhej sikur kishte pranë të vëllanë. Ashtu bisedonte edhe me të, shpesh, deri në orët e vona. Shumë gjëra nga ato që thoshte Halimi, ajo nuk i kuptonte, por një gjë e dinte mirë: do të vinte një ditë që do të ishte ndryshe nga të tjerat. Do të punonin e do të jetonin si njerëz.... Ndoshta atëherë ajo do të qepte edhe fustanin e bardhë, me trëndafila të kuq, që ia kishte dhuruar Halimi... Asaj i kujtohej nata e gjatë e pritjes. Prisinin me nënën që Halimi të kthehej nga qyteti. Ai ishte ilegal. Dhe ja, qeni kishte lehur në oborr i gëzuar dhe ato ishin ngritur në këmbë me rrëmbim.

— Po përse bëheni kaq merak? — kishte qeshur ai. — Sikur ma taksni me merakun tuaj.

— E si të mos bëhemi merak, luftë është dhe ty të kemi burrë në shtëpi, — i kish thënë nëna.

Ai e kishte parë me dashuri dhe, duke i buzëqeshur Besës, i kishte vënë në dorë një pako të mbështjellë.

— Është për ty, motër. Ehëëë, kushedi për cilin do bëhesh merak një ditë, moj kunadhe! — e kishte ngacmuar...

Vajza kishte hapur pakon dhe i kishte shpëtuar një psherëtimë e beftë: një copë e bukur për fustan, e bukur sa nuk kishte parë deri atëherë. Po mbushte të dymbëdhjetat dhe ajo ishte dhurata e parë që i bëhej.

— Të keqen motra, vëllai i motrës! — Duke ardhur rrotull nëpër dhomë, vajza kishte kërkuar copën e thyer të pasqyrës. Me rrobën e mbështjellë në gjoks kishte përkulur kokën mbrapa për t'u parë më mirë. Nënës i regëtinte në zemër gëzimi i çupës. Gëzohej e mendonte. Nëna qeshte e vëllai qeshte. Dhe i kishte gjetur mëngjesi zgjuar... Të nesërmen Halimi kishte dalë në mal.

Një zhurmë e lehtë e shkëputi nga ëndërrimi. Ishte një zog i vogël që përplasi krahët në xham. «Do të bjerë dëborë e re», tha vajza me vete. Nga dritarja dukej një copë qiell me yje të rralla, që po zbeheshin.

— Fjete, Besa?

— S'më zë gjumi!

— Mendohesh?

Vajza heshti një çast, pastaj u kthye nga partizania. Sytë i shkëlqenin.

— Ç'do të bëhesh ti, Liri, kur të çlirohet Shqipëria?

— Unë? — Kaq herë kishte ëndërruar e biseduar me shokët, pas betejave, për ato ditë të buku-

ra që do të vinin. Por se çfarë do të bëhej... Vërtet, ç'do të bëhej?... «Ne do të kemi një ditë edhe mësuesit tanë», i kujtohej se kishte thënë njëherë komisari.

— Mbase do të bëhem mësuese, Besa, — tha papritur.

— Mësuese? Mirë, kaq mirë!...

— Po ti, Besa?

— Unë?!...

Ç't'i thoshte?

Ashtu shtrirë, me vështrimin të ngulur në errësirë, pëshpëritën për një kohë të gjatë.

Herë-herë, në qetësinë e dhomës, ndihej vetëm frymëmarrja e tyre. Pastaj, papritur, ndonjëra pyeste diçka e përsëri biseda niste si më parë. Figura e partizanes i qëndronte para syve. Ama, çupë e bukur ishte. Sa i shkonin edhe rrobat partizane, armët, bluza, kapela me yll dhe ai shalli i kuq. Edhe rrobat e nusërisë do t'i shkonin. Nuse, pa, ç'nuse do të dilte! Vajza u mundua ta përfytyronte Lirinë të veshur nuse. Ç'fustan do t'i shkonte me flokët dhe sytë? Një mendim i beftë sikur... Ndjeu faqet t'i ndizeshin prush. U ngrit dhe trazoi pak zjarrin me masha. Drita e tij lodronte në fytyrën e partizanes. Ajo flinte e qetë. Në fytyrë i endej një buzëqeshje e ëmbël. «Ndofta sheh ëndërr. Ajo është e re, as të shtatëmbëdhjetat nuk i ka mbushur. E pse jo, ndoshta ëndërron edhe ditën e dasmës». E, tek mendonte kështu, me hap të ngadaltë iu afrua sëndu-

kut. Nxori dhuratën dhe, si e puthi, e afroi te gjoksi. «Halimi i motrës. Sa qejf kishte të më shikonte të veshur bukur!» Vajza fshiu pikën e lotit dhe u mundua të buzëqeshte. Nga dritarja dhe të çarat e dhomës po hynte drita e mugët e mëngjesit. Ngadalë ajo u fut në rroba dhe me atë copën e bukur në gji e zuri gjumi pranë partizanes.

Të nesërmen ato ecnin të tria drejt shtegut që të çonte në mal. Qielli ishte bërë i kthjellët dhe dukej si i larë pas dëborës. Përreth, mbi degët e ngarkuara të pishave dhe bredhave, një zog i gëzohej bardhësisë. Nënë Hasimeja ecte përkrah partizanes dhe e porosiste diçka. Kur nëna, siç duket, e tepronte me këshillat, partizania qeshte pa të keq. Tingëllimi i zërit të saj i përcillte diçka të gëzueshme edhe Besës, që ecte përpara.

Mbi një kodër u dukën partizanët që prisnin. Liria i përshëndeti me dorën grusht dhe qëndroi. Hasimeja e pa me fytyrë të mallëngjyer. I kopsiti jakën e xhaketës, i mbështolli shallin e kuq rreth gushës dhe, si i përkëdheli kokën, e mbuloi me të puthura.

— Me fitore të më kthehesh, bijë!

— Mirupafshim në Shqipërinë e lirë, nënë!... Mirupafshim, Besa! — Atë çast vajza iu ngjiti fort pas trupit dhe i zgjati partizanes një pako të mbështjellë.

— Merre.... Qepe dhe vishe kur të çlirohemi... kur të bëhesh nuse...

Filloi era dhe pylli aty pranë sikur oshëtinte.

Nënë e bijë qëndronin pranë e pranë dhe ndiqnin me sy partizanët që po largoheshin. Kushedi përse, Besa ndihej e sigurt se ajo partizania e bukur do të jetonte patjetër dhe një ditë, në dasmë, do të vishte pikërisht fustanin me trëndafila të kuq, që ia kishte falur me gjithë zemër motra e shokut, kur po ndaheshin...

MOZAIKU

Arkeologun s'e zinte vendi. Ecte tutje-tëhu nëpër sheshin e fshatit.

Ai kërkonte një mozaik dhe kishte dy javë që kishte ardhur në ato anë. Tani priste të takonte një fshatar që quhej Çobo. Thuhej se mozaiku ndodhej diku rreth kalasë. Ai përmendej në dokumente, për të flitnin studiues, arkeologë, ekspeditorë... Arkeologu kishte kërkuar në fshatrat përçark, por më kot. Në banesat e fshatrave kishte parë objekte të ndryshme. Në shtëpinë e Rrapo Gushit kishte parë edhe një enë të vjetër balte. Ajo ishte pikturuar nga jashtë dhe fshatari e kishte bërë saksilulesh. Në një shtëpi tjetër i ra në sy një gur i gdhendur, me mbishkrime, vënë mbi dollap si stoli. Rreth e rrotull arkeologu kishte gjetur thika, sëpata, enë qeramike, po në gjurmët e mozaikut s'kishte

rënë. Ditët e fundit dikush ishte kujtuar në fshat dhe i kishte thënë:

— Pyet edhe Çobon njëherë... Një llaf ke për të humbur.

Arkeologu sepse mendoi se Çoboja do të ishte mësues apo punonjës kulture, por Çoboja ishte bari dhe pjesën më të madhe të kohës e kalonte në mal... Pikërisht Çobon po priste te sheshi i fshatit. Po ngrysej dhe arkeologu nuk ia dalloi mirë tiparet. Ndoshta mund të ishte rreth të dyzetave. Zërin e kishte disi të ashpër po, nga mënyra se si fliste dhe nga vështrimi hetues, dukej njeri i matur.

Siç pritej, Çoboja e ftoi në shtëpi. Dolën nga qendra e fshatit dhe morën një të përpjetë. Shiu vazhdonte të binte, i imët, si i situar. Herë-herë, mbi shushurimën e tij, ngrihej jehona e një kënge me iso.

— Është kënga për Meton, — tha Çoboja. — E ka ngritur Abazi, dhe djemtë e këndojnë shpesh në vatrën e kulturës.

Arkeologu qëndroi një çast dhe pastaj ndoqi fshatarin. Çoboja e kishte shtëpinë mbi kodër, disi larg fshatit. Shtëpia ishte ngritur me gurë. Hyrjen e kishte në formë gjysmëharku, tipike për atë krahinë. Edhe avllia rreth e qark ishte ngritur me gurë. U ndie lehja e qenit. Çoboja fërshëlleu lehtë dhe lehja, në fillim kërcënuese, u kthye në një kuisje të lehtë e miqësore.

— Urdhëroni! — priu i zoti i shtëpisë, duke i treguar mikut njëren nga dy dhomat.

Arkeologu u ul ndanë vatrës. Çoboja i hodhi dru zjarrit dhe i zgjati mikut kutinë e duhanit.

Ai nisi ta dridhte cigaren me sytë nga i zoti i shtëpisë. Tani dukeshin mirë tiparet e tij të theksuara, fytyra disi e rrumbullakët dhe e shëndetshme, sytë ngjyrë hiri me një si dritë kureshtjeje te bebëzat. Fshatari mbante qeleshe me majë dhe në pjesën e ballit i kishte dalë një bisht kaçurreli.

Ndërsa arkeologu mendonte në duhej ta hapte bisedën për të cilën kishte ardhur, në dhomë hyri një grua me një vajzë nja katër a pesë vjeçe. Të dyja ishin veshur me triko të bardha leshi. Gruaja e përshëndeti, iu përgjigj diçka të shoqit për kursin kundër analfabetizmit, pastaj vari llambën me vajguri në mur.

— Hajde te xhaxhi, — i thirri arkeologu vajzës. Ajo rrinte e druajtur te dera dhe shihte si e habitur herë mikun e herë të atin. Pastaj erdhi dhe iu ul në prehër. Në atë gjest fëmija kishte diçka të ngrohtë e të dashur, që arkeologut i kujtoi shtëpinë.

— Si e ke emrin?

— Liri.

Ishin vitet e para pas Luftës dhe ai emër kishte zënë të përhapej shumë.

— E kam të vetme, — tha Çoboja.

— Me jetë të gjatë! — Arkeologu e ledhatoi vogëlushen dhe i ngriti disa fije floku që i kishin rënë mbi ballë. Papritur u shtang një çast: në triko, mu në gjoks, ishte qëndisur me ngjyrë të kuqe një zambak i bukur. Përçark tij kishte ca figura të vogla gjeometrike në ngjyra të ndryshme. Ai ndjeu diçka të re brenda vetes dhe sepse iu duk

sikur zemra filloi t'i rrihte ndryshe. Sa s'po e përpinte me sy figurën.

— Kush e ka qëndisur? — pyeti të zotin e shtëpisë.

— Gruaja, — tha. — Këtej nga anët tona gratë qëndisin mirë, — qeshi Çoboja.

— Po ku e ka marrë modelin?

— Ah, modelin, — përsëriti Çoboja. — Ja, ashtu... vetë ia dhashë.

Arkeologu mendoi se, më në fund, po e kapte disi fillin e atij lëmshi që e mundonte dhe tani kërkonte që ta tërhiqte me nxitim.

— Po ti e ke parë gjekundi, apo...?

Çoboja s'foli. Për disa çaste u mor me çibukun. E zbrazi, e mbushi përsëri e filloi ta ngjishte me gishtërinjtë e zverdhur nga tymi. Arkeologu po e shihte me padurim. Bariu mori një shkop, që e kishte aty në anë të oxhakut, nxori një thikë nga xhepi i brendshëm e filloi ta gdhendte. Në dhomë dëgjohej zhurma që bënte thika dhe kërcitjet e zjarrit.

Një flutur nate filloi të vërtitej rreth llambës. Kishte diçka bezdisëse dhe të ngjallte një ndjenjë nervozizmi. Arkeologu ngriti kokën, por... Vetëm atëherë vuri re se tavani i shtëpisë ishte gdhendur me një bukuri të veçantë e shije të hollë. Si s'e kishte vërejtur që në fillim? Lloj-lloj figurash. Edhe motivi i atij zambakut, që ishte qëndisur në trikon e vajzës, ishte gdhendur në dru me përmasa të mëdha.

— Po ti ç'e do? — u kthye papritur në bisedë Çoboja.

— Jam arkeolog dhe kam ardhur për kërkime. Flitet se në këtë krahinë ndodhet një mozaik me vlera të mëdha. — Dhe pastaj nisi t'i shpjegonte se çfarë ishte mozaiku dhe vlerat e tij. Çoboja e shihte në dritë të syrit.

— Dikur e kanë kërkuar edhe të huajt, — tha arkeologu. — Mos ke dëgjuar gjë për këtë?

Biseda u ndërpre një grimë herë. Bariu vështronte vatrën dhe nëpër sy i luante drita e zjarrit. Ndërsa arkeologu bluante me vete: «Ata kërkuan shumë, — mendonte për të huajt. — Venin e vinin nëpër fshatra, mblihdnin copa tjegullash me ngjyrë, në prej balte, thika të vjetra. Ata rrëmbyen vepra me vlerë dhe, shumë nga ato, i quajnë si të tyre.» Iu kujtua se një ditë, në një nga qendrat e mëdha arkeologjike, erdhën disa të huaj. Një burrë dhe një grua bisedonin në gjuhën e tyre përballë një statuje.

«Kjo statujë i ka sandalet si të miat», — po thoshte gruaja.

«Po, po», — habitej burri.

Arkeologu, që i kishte dëgjuar, ndërhyri me takt:

«Ka të ngjarë që ju t'i keni sandalet si të statujës, zonjë. Siç mund ta dini, kjo statujë është krijuar shumë kohë para lindjes suaj.»

— Para Çlirimit, ca të huaj patën ardhur edhe në shtëpinë time, — u kujtua Çoboja. — Mbaj mend se na premtuan edhe para, por nuk u dhamë gjë.

— Ndoshta kërkonin edhe mozaikun, — i dogji arkeologut menjëherë. — Po, me sa duket, toka e

ka fshehur diku thellë, si për ta ruajtur prej tyre.

Çoboja qeshi me zë dhe trazoi zjarrin. Tjetri kishte filluar t'i fliste diçka për zanatin e tij. I thoshte se tani kishim arkeologjinë tonë dhe se vlerat e këtyre veprave do të mbeteshin pronë e popullit, sepse atij i përkasin.

Çoboja dëgjonte dhe tundte kokën për të thënë: «po». Dukej se e ndiente që miku po fliste për diçka të bukur e të mirë, megjithëse nuk e kuptonte plotësisht. Kur arkeologu mbaroi, fshatari shkundi çibukun pas një kërcuri dhe ndezi më shumë kërsërinë e tjetrit:

— Po mirë, xhanëm, kaq e vlefshme është për popullin ajo që kërkon ti?

— Po, është shumë e vlefshme... dhe jo vetëm ajo, por edhe shumë zbulime të tjera. Ato tregojnë kulturën e lashtë... Na duhen, Çobo, na duhen! — i dha tonit një ngulmim.

I zoti i shtëpisë u mat disa herë dhe sikur deshi t'i thoshte diçka, po në çastin e fundit, kushedi përse, u pendua dhe hoqi dorë.

Gruaja solli kafën.

Arkeologu mori filxhanin, po mendja gjithnjë punonte aty: si të binte në gjurmë të mozaikut? Ndoshta, ky fshatar do ta ndihmonte me ato motivet e bukura, që ishin qëndisur e gdhendur në atë shtëpi. Ku t'i ketë parë? Hodhi sytë nga Çoboja. I zoti i shtëpisë, si t'ia kishte kuptuar hallin, i tha:

— Sonte fli te ne. Nesër shohim e bëjmë. Mbase shkojmë nga stanët,

Arkeologu priti se mos do t'i thoshte dhe ndo-
një fjalë tjetër, po fshatari ndërroi bisedë. Kështu
erdhi rasti që mësoi se edhe babai i Çobos kishte
qenë gdhendës i njohur në tërë krahinën. Pastaj
folën edhe për kooperativën që do të ngrihej
së shpejti në fshat, për centralin elektrik. Atë natë
arkeologu fjeti fare pak. Herë-herë ngrihej nde-
njur mbi shtroja e mendonte për mozaikun. Sikur
ta zbulonte! Kjo do të ishte një pasuri e madhe për
qendrën arkeologjike, që sapo ishte krijuar. Për-
fytyroi takimet, bisedat që kishte pasur me fsha-
tarët, fjalët e Çobos. Një shkëndijë shprese, si
diçka e papërcaktuar, e bënte të ndiente gëzim.
«Po Çoboja përse më tha të shkojmë në stan?
Mos vallë ka zbuluar gjë? Po pyetjet që bënte?»
Kur ishte nisur për në fshat, dikush kishte thënë se
kot e kishte atë punë. Në atë krahinë ishin endur
për një kohë të gjatë edhe të huaj me përvojë në
kërkime dhe nuk kishin gjetur gjë, e jo më...
Ndërsa Pandi, një arkeolog i moshuar, duke e parë
përmes xhamave të trashë të syzeve, i tha: «Të më
bënin këmbët, do të vija dhe unë!» Ndërsa men-
donte kështu, nxori nga xhepi i xhaketës një letër,
ngriti fitilin e llambës e filloi të rilexonte. Letrën
ia shkruante i biri, tetëmbëdhjetvjeçar. Ai ishte
vullnetar në hekurudhë. «Hë, baba, gjete gjë apo
jo? Unë lexoj përditë gazetën dhe pres me padu-
rim lajmin e zbulimit.» «Hë, qerratai, — ia bëri
arkeologu, — kujton se kjo punë është njëlloj si
të bësh petulla...»

Në mëngjes, me të dëgjuar zërin e Çobos,
u gjend në këmbë.

— Shkojmë, — i tha menjëherë.

Një buzëqeshje u end në fytyrën e fshatarit. Edhe poshtë syve të tij ishin formuar disa rrrathë të lehtë.

— Marrim bukën e mëngjesit me vete e nisemi,
— tha fshatari.

Gruaja solli torbën dhe ata u nisën. Shiu kishte pushuar dhe hapësira dukej e kthjellët dhe e lehtë. Ata herë ngjiteshin në të përpjeta herë binin në luginë; Çobojë ecte përpara, duke larguar me kërrabë degët e shkurreve për t'i hapur udhë mikut. Me trupin e tij prej atleti, me ato këmbët pak të përthyera në gjunjë, fshatari kërcente gur më gur. Edhe arkeologu e ndiqte me të njëjtin hap. Nga lart vinin fshatarë me kafshët e ngarkuara me qereste. Njëri qëndroi një çast me Çobon dhe ia bëri me sy nga arkeologu.

«Kërkon antika», dëgjoi arkeologu zërin e ulët të Çobos. Fshatari tundi kokën, e pa me kureshtje dhe e përshëndeti. Tej, mbi qafë, një fshatar tjetër ngrinte një furrë për pjekjen e gëlqeres. Ai la një çast punën dhe ua bëri me dorë. Ata ecnin me të njëjtin hap. Kishte dalë dielli. Në qiell dukeshin vetëm disa re të bardha që i shtynte një erë e lehtë. Çobojë ndaloi, vuri njëren këmbë mbi gur, u mbështet në kërrabë dhe e pa arkeologun i menduar.

— Po ju, po ta gjeni... do ta merrni me vete atë? — pyeti papritur.

Sytë e Çobos sikur përpiqeshin të depërtonin në fytyrën e arkeologut.

— Jo, mozaikun nuk do ta marrim. Përçark do të bëjmë gërmime dhe do ta ruajmë si monu-

ment kulture. Pastaj mund të vijnë njerëz nga të gjitha anët për ta vizituar. Po përse pyet?

— Hiç, ashtu kot, — tha Çoboja.

Kishte ecur rreth dy orë, kur mbi faqen e mallit përballë u shfaq një stan. Prej andej vinte blegërima e dhenve. Rreth e qark syri të zinte lëndina të mbuluara me bar të ri.

— Shkojmë nga kasollja, — tha bariu.

— E ç'të bëjmë në kasolle? — s'iu durua tjetrit.

Çoboja s'foli, por mori më të majtë. Filluan t'i ngjiteshin një së përpjete tjetër. Pas pak dolën mbi një pllajë. Aty ishte ngritur edhe kasollja e barinjve. Ajo ishte e madhe, me dy të ndara. E ndara e parë kishte gjithçka që i nevojitet bariut. Çoboja mbushi një gotë me kos.

— Pije, se të bën mirë, — i tha arkeologut.

Ai e piu me një frymë. Çoboja dukej në qejf. U afrua te dera që të çonte në të ndarën tjetër dhe hoqi opingat.

— Hajde, hajde këtu, — e ftoi mikun.

E ndara tjetër ishte si një dhomë-muze. Në mure ishin vënë gjithfarë punimesh druri. Poshtë ishte shtruar një rrogoz i gjerë, ndërsa mbi një trung ishin vendosur, radhë-radhë, disa enë balte, copa tjegullash me ngjyra... Arkeologu gati u lëshua mbi to, po Çoboja e kapi nga dora.

— Prit! — e mbajti me të qeshur. — Dale, dale njëherë!

Arkeologu e pa në sy i habitur. Bariu nuk foli. Ai hapi me kujdes njërin anë të rrogozit dhe e ngriti të tërin. Në fillim arkeologu shtangu, pastaj lëshoi një murmurimë habie dhe gëzimi. DysHEMEJA

e asaj kasolleje ishte një mozaik. Ashtu, me ato vizatime shumëngjyrëshe, ai i ngjante një qilimi të bukur. Arkeologu njohu edhe motivin e atij zambakut, që ishte qëndisur në trikon e vajzës së Çobos.

— Është shumë i bukur, — tha fshatari. — Babai më thoshte se e kanë bërë të parët tanë. Kam qenë i ri kur ma ka treguar për herë të parë. Tamam në atë kohë të huajt kërkonin këndej rrotull...

Arkeologu humbi pas asaj gjëje të rrallë që kishte krijuar dora e njeriut. Kalonte sa në njërin cep te tjetri. Pas një grime u ul në gjunjë dhe zuri ta pastronte me furçë. Ndërsa Çoboja e ngacmonte i kënaqur.

— Ama, u lodhe vërtet, po rruga nuk të shkoi humbur, ë?

Mozaiku ishte ruajtur mirë.

BIE CYLJA

Tartari kaloi Qafën e Pazarit dhe mori të përpjetën që të çonte në kala. Po binte muzgu i mbrëmjes. Nëpër rrugët e kalldrëmta ndihej lëvizje dhe gjallëri e madhe: dukej sikur kishte ardhur aty Shqipëria mbarë me etnografinë e vet dhe shëtiste gazmore. Ai ngjiste të përpjetën i shqetësuar. E kishin vënë në mendim fjalët e atij specialistit. E si i kishte thënë ai? «Të hiqen fyejt nga kënga, se s'ka tempo, ritëm!» Thua, vërtet e kishte futur kot fyellin në këngë? Se ai e dinte mirë që çdo gjë e tepërt nuk është art.

I erdhi ndër mend ajo ditë kur krijoi vargjet e këngës. Kishte qëndruar midis lisave të fshatit.

Tej dukeshin malet e shumta me gërxhe e brinja. Më poshtë ishte deti, që sikur kërkonte t'i thoshte diçka me atë shushurimën e lehtë të valëve. E atje në faqe të malit, si pulëbardhë, Bejka zbriste shkëmbin (si dëbora e malit, kishte thënë ai me vete). E përfytyronte me atë ecjen e lehtë, me sytë që i vetëtinin, faqet që i skuqnin nga purpuri i dashurisë... Ndërsa atje, te stani, nga vinte blegërima e bagëtive, qëndronte me kërrabë e shark mbi supe djaloshi çoban. Ai i binte fyellit duke e mbajtur pak mënjane. Bagëtia, si të mbante iso, tundnin zilet e këmborët, hanin barin e njomë e përkëdhelnin qengjat... Tartari ishte befasuar dhe vargjet kishin rrjedhur natyrshëm.

*Duke u tundur zbret nga zalli,
me shami hedhur te balli,
Bejkë e bardhë, o borë e malit...*

Po ç'pati ai, xhanëm? Ç'e gjeti me tempo-ritmin?! i erdhi në mend. Këngën e kishin dëgjuar dhe specialistë të tjerë, njohës të këngës polifonike dhe e kishin pëlqyer, kurse ky... Dhe ai vazhdonte të ecte i shqetësuar. Tej u dukën qartë bedenat e kalasë.

Atë mbrëmje grupi ishte mbledhur, si zakonisht, në shtëpinë e kulturës. Ai u propozoi që në festival të shkonin me këngën e re që kishte krijuar.

— Si thoni? Ç'thua ti... Bejkë, — iu drejtua Lenit, marrëses leshverdhë e vetullazezë. Vajza buzëqeshi. Të tjerëve u xixëlluan sytë. Pas pak, zëri melodioz i Lenit, aq i njohur për të gjithë ata, nisi këngën e Bejkës. Ymeri me Selfon vunë fyejt

në buzë. Isoja mori malin, u përhap mbi agru-
met, mbi vreshtat, mbi sipërfaqen e detit. Po-
thuajse pa prova, ata e bënë të tyre atë këngë.
Vunë re se jashtë ishin mbledhur mjaft njerëz,
turma sa vinte e rritej. Duke kënduar, ata dolën
jashtë te burimi i rrapit, në mes të fshatit. Ishte
një rrap shekullor, ku dikur kuvëndonin pleqtë.
Sot atje mbliidhej fshati e kuvendonin, mbliidhej
grupi e këndonin, mbliidheshin fëmijët e cicëro-
nin të gëzuar. E atë mbrëmje isoja e Bejkës e
rrethoi rrapin. Fyejt shoqëronin e isoja kumbon-
te. Kënga u kishte hyrë në shpirt të gjithëve.
Fshati e deshi atë këngë...

U shkëput nga mendimet. Një erë e hollë fi-
lloi të frynte nga malet që rrethonin qytetin. Ajo
sillte copa bisedash, tinguj këngësh, e sikur kër-
konte t'i grumbullonte atje të gjitha, në kalanë
shekullore. Ndjeu t'i mbushej shpirti me gëzim, por
ky qe vetëm një çast, sepse përsëri ra në mendime.
Pyetjet i vinin njëra pas tjetrës. Pse, ka çoban
pa fyell? Si do të bisedojë çobani me Bejkën? E
ç'do të thotë Ymeri? «Pse na hoqe fyellin, o
Tartar!» Po Selfoja? Selfoja do ta shihte me qe-
sëndi e do t'i thoshte: «Tartar, vëlla, po na prish
këngët, po na nxjerr avaze të reja!» Po fshati ç'do të
thoshte? Fshati do të qeshte nën zë... E përpjeta
po e djersinte apo... fyelli, tempo-ritmi... E ç'ka ky
«tempo-ritmi» sonte që kërkon të futet kështu haj-
dutçe në këngën tonë, kërkon të rrëmbejë fyellin
e Ymerit, të Selfos... Atë pasdite u kishte propo-
zuar që të bënin një provë pa fyej. Ata e kishin
parë atë me keqardhje. «Nuk vete kështu, o Tartar.
Ç'të paska hipur sot!» — dukej sikur thoshin sytë

e tyre. «Nuk vete, jo», — kishte folur me vete edhe Tartari, por atyre nuk u tha gjë.

Pak më vonë kishte takuar përgjegjësën e një grupi tjetër.

— Po ty ç'të ka thënë specialisti për fyejt, o byrazer? — e kishte pyetur Tartari, duke i treguar hallin që e kishte zënë.

Tjetri e kishte parë me habi.

— Ai yni është t'i pish dollinë. Na erdhi në fshat vatër më vatër e, si i pa mirë punët, na bëri një propozim. E di çfarë? Të bashkojmë fyejt, na tha, e jo një e nga një. Të gjithë e pëlqyem, bëmë prova e kështu do të dalim.

Tartari e dëgjonte me vëmendje.

— Po për tempo-ritmin ç'tha? — I kishte ngelur gozhdë.

Tjetri heshti një çast, pastaj i vuri dorën në sup dhe i tha me të qeshur:

— Dëgjomë mua, unë jam çoban. Po edhe kur e kam pranë Bejkën, atë që ia them me fyell, s'ia them dot me fjalë. Po më dëgjove mua, më mirë prano të heqësh fjalët, pa fyellin kurrë. Sa për atë punën e tempo-ritmit... E, xhanëm, tempo-ritmi duhet, po kur fyelli bie ëmbël, atë e bën zemra me rrahjet e saj.

Iu bë se dëgjoi zëra të njohur, ktheu kokën. Pas i vinin shokët. Selloja po ia bënte me dorë. Dukeshin të gjithë në humor të mirë. Ata s'e dinin hallin e tij...

Koncerti kishte filluar. Grupi i tyre ishte caktuar në fillim. Erdhi çasti të dilnin në skenë, kur aty pranë u duk specialisti. Fytyra i shkël-

gente nga djersët. Një kollaro e shkurtër, e gjerë e me vija të kuqe i qëndronte mbi barkun pak të kërcyer. «Pse s'e heq kollaron ky? Ajo sikur s'ka... tempo-ritëm.» — Tartarit i erdhi ta ngacmonte. Po heshti. Ndërkohë tjetri po i thoshte, pa e pasur fare mendjen aty:

— Ashtu siç biseduam, ë?

Tartari e pa drejt në sy.

— E bëra një provë pa fyej, ashtu siç thua ti, po kënga nuk më del.

— Të është dukur. Ju jeni mësuar ashtu dhe e keni ca të vështirë në fillim. Fyelli, si një element... Po shpejt do të mësoheni. Kështu, hë!... Hajde, bëhuni gati tashti, se do të dilni, — tha ai dhe i rrahu shpatullat.

— E di ç'ke, — iu kthye Tartari me ton disi lutës, — na lër të këndojmë siç e kërkon kënga.

— Nuk mundem, nuk mundem. Këngën do ta këndonin pa fyej. Epo, ju lutem, ne sikur u morëm vesh tani! Ndryshe... do t'ia them këto edhe drejtueses së festivalit.

— Si tha, s'do të këndojmë, s'do të dalim në skenë?! — pëshpëritnin pak më tej me njëri-tjetrin pjesëtarët e grupit. Ata shihnin të habitur nga specialisti. Në fytyrat e tyre ndihej brengë e mërzi. «Nga doli ky, more Tartar? Ç'thotë ky, more Tartar? Përse kërkon t'ia heqë fyellin çobanit?»

— Mbaroi tani. Hajt, suksese! — tha specialisti. Megjithatë diçka i pëshpëriti drejtueses së festivalit. Ajo bëri me kokë dhe pa me habi e keqardhje nga grupi. Ata ndiheshin të shqetësuar. Tartari i pa disa çaste në sy. Pastaj papritur një nënqeshje e lehtë i kaloi në buzë.

Dolën në skenë. Përballë kishin mijëra shikues nga tërë Shqipëria. Pritje dhe kureshtje për atë që do të dëgjonin. Grupi i tyre ishte bërë i njohur, prandaj dhe të gjithë prisnin këngë të bukura. Për disa çaste u vendos heshtje. Tartari pa nga Ymeri. Djaloshi lëvizi njërin nga mikrofonat dhe i buzëqeshi lehtë Lenit. Ajo dukej e sigurt. Lëvizi pak flokët dhe drejtoi shikimin. E Ymeri me Selfon hapën sharqet e nxorën fyejt nga brezi. Një duartrokkitje përshëndeti nxjerrjen e fyejve. Diku aty anash tyre u dëgjuan zëra të ulët. Ata njohën zërin nervoz të specialistit, i cili u shtang dhe po shihte i vrenjtur nga grupi.

— S'mbaj përgjegjësi unë, s'mbaj...

Melodia baritore e fyejve dhe më pas zëri i kristaltë i Bejkës, mbytën atë murmurimë dhe u përhapën lehtas nëpër ajër, mbi kala, mbi qytetin e gurtë.

Tartari, midis grupit, mbante iso e shihte anash, ku akoma ndihej një lëvizje e lehtë që po fashitej: specialisti jepte e merrte me lëvizje të duarve, të kokës e të syve. Fyejt e Ymerit e të Selfos sikur e trembnin. Asnjëri, me sa dukej, nuk ia vinte veshin. Të gjithë ishin përfshirë në melodinë e këngës. Zëri i marëses gurgullonte:

*Në mengjes, pa dirë mirë,
do takoj djalë barinë,
bëj të flë, gjumi s'më zë,
cula bie ëmbëlë!...*

Ndërsa këndonte këto vargje, ajo shihte me çapkënllek nga fyelltarët. E çylja ndizej e jehonte,

si t'i fliste Bejkës, si t'u fliste maleve, përshëndetej me to e përsëri kthehej. Tartari i kërkonte me sy. Sytë e tyre takoheshin e bisedonin me afshin e këngës.

Për një çast përqendroi vështrimin te Bejka. Po tashti? Margariti me fyell do t'i afrohej pranë asaj, do të hapte sharkun e do të fuste në të Bejkën...

Ato ditë, ndërsa shkonte nëpër mend këngën, ndiente se diçka mungonte. Si artist, ai e kuptonte këtë gjë. Para se të fillonin këngën, thirri Lenin pranë:

— Kënga është e bukur, Leni, por unë kam një mendim.

— Çfarë, Tartar?

— Po ja, sikur Ymeri në fund të këngës të të hedhë sharkun e tij...

Vajza buzëqeshi e një ngjyrë trëndafili i ra në faqe.

— Mos u bëj merak, more Tartar, ashtu do bëjmë.

Ai kishte qortuar veten që kishte pasur një hije dyshimi për përgjigjen e vajzës.

Dhe ja, kënga po afron te vargjet:

*Bejkë e bardhë, o borë e malit,
ti je ilaç i çobanit...*

Isoja buçiste si gurgullimë përrenjsh. Ymeri hapi sharkun. Bejka lulëkuqe u fut nën shark. Isoja u përzie me duartrokite, që përshëndetnin me ngrohtësi.

Grupi zbriste rrugëve të kalldrëmta. Kalaja

shkëlqente nga dritat. Jehona e Këngës së Bejkës sikur kishte mbetur në buzët e njerëzve, që kishin nisur ta këndonin. Disa ecnin pranë grupit, u kërkonin që ta këndonin përsëri atë këngë. Diku midis tyre Tartari dalloj edhe fytyrën e specialistit. Ai ishte akoma i hutuar. Ç'do të thoshte, vallë, pas asaj pritjeje të ngrohtë që iu bë këngës?

Në kala ndritnin dritat e festivalit.

TË NESËRMEN IKU...

Atë pasdite në qytetin tonë buzë detit ra dëborë. Ne fëmijët rrinim pranë dritares dhe shihnim me gëzim e kureshtje se si binte e qetë dhe shtruar mbi tarracat e pallateve, mbi rrugët, pemët dhe fushën e vogël të sportit. Nga jashtë vinin thirrjet e fëmijëve të lagjes që luanin me topa dëbore.

— Ka kohë që nuk ka rënë dëborë këtu, — tha nëna disi e menduar.

— Te ne mban tërë dimrin, — tha daja. Ai rrinte përkundrejt dritares dhe pinte duhan i qetë, duke na buzëqeshur me dashuri neve të vegjëleve, që i gëzoheshim dëborës. Daja ishte blegtor dhe kishte ardhur një natë më parë. Kur dëgjuam fjalët

e tij, ne vështruam njëri-tjetrin me habi: na u duk gjë e madhe që atje ku rronte ai kishte gjithnjë dëborë.

— Besoj se sot do të vijë Bedua, — tha daja për babanë.

— E kishte për të ardhur dje, — tha nëna, e merakosur. Pastaj duke u munduar të dukej e qetë, pa nga ne me ëmbëlsi dhe shtoi, si për të na gëzuar: — Do të vijë sot, do të vijë patjetër!

Babai kishte disa ditë me shërbim dhe ne na kishte marrë malli.

Daja na mori pranë e nisi të na tregonte një ngjarje nga jeta e tij. Dëborë i kishte zënë papritur në mal me bagëtitë dhe ata nuk mund të zbrisnin në fshat. Veç tufanit të dëborës, i kishte sulmuar edhe një kope ujqish. Disa ditë rresht kishin luftuar për t'u siguruar ushqim bagëtime dhe për t'i mbrojtur nga ujqit e uritur. Pastaj kishin ardhur shokët dhe...

— Kjo dëborë qenka e keqe, — tha Nora, motra ime e vogël, që s'ia kishte ndarë sytë atij asnjë çast.

Ai i ledhatoi faqet duke qeshur:

— Është dhe e mirë, se ngordh mikrobet.

— Dëborë është e bukur, sa e bukur! — u hodh Lida, vajza e xhaxhait, që kishte ardhur kur daja tregonte.

— Po nga delet asnjë nuk ngordhi? — pyeta unë. Më kishte mbetur mendja atje në mal, te delet e tek ujqit.

— Jo, — tha daja, — asnjë.

— Po ujku, asnjë nuk hëngri?

— Jo, jo, — qeshi prapë ai me kureshtjen time.
— Po ti, ke qejf të bëhesh çoban, a si? — m'u drejtua pastaj.

— Kam, — iu përgjigja.

— Pse çoban? — tha Lida. — Titi do të bëhet kompozitor, se ka vesh për muzikë.

Nora, që rrinte pranë meje, vështroi si me çudi veshët e mi. Daja bëri buzën në gaz, por e ndjeva se nuk i erdhi mirë nga fjalët e Lidës. Apo ndosh-ta m'u duk ashtu? Ah, kjo Lida, si flet nganjëherë! Kjo vazhdon liceun artistik; e duam shumë, se këndon bukur, por nganjëherë na mërzit. Se ç'thotë ca fjalë që s'para i kuptojmë. Babai e qorton, por ndërhyt nëna dhe e merr në mbrojtje. Apo e sheh Lidën drejt e në sy kur flet, sikur s'është nxënëse, por profesoreshë muzike!... Kurse daja është nga ata njerëz që të hyjnë në zemër me fjalët e para. Sidomos me ne të vegjlit është i dhembshur. Ai di ngjarje e histori që neve na pëlqejnë shumë. Dhe ka një të mirë: nuk mërzitet nga pyetjet tona, siç mërzitet nganjëherë babai apo Lida.

Ndërkohë që vazhdonte biseda, u hap me rrëmbim dera dhe hyri tërë gjallëri babai. U derdhëm drejt tij si zogj. Nëna i mori pelerinën, ndërsa unë çantën dhe kapelën. Ai u përqaftua me dajën dhe pastaj me ne të gjithë. Mua sepse po më dukej më ndryshe. Ishte hequr pak në fytyrë dhe herëherë shtypte vetullat me gishta. Edhe zëri sikur i ishte ngjirur pak. Me sa dukej, këtë e vuri re edhe nëna, sepse e pyeti:

— Mos je ftohur, Bedo?

— Jo, — tha ai dhe fërkoj duart. Pastaj më ledhatoi mua, mori Norën në prehër dhe ia nisi bisedës me dajën.

Ne të tjerët dëgjonim me vëmendje. Babai po tregonte për udhëtimin. Ishte nisur një ditë më parë nga qyteti K, po rrugët ishin zënë.

— Ka rënë dëborë e madhe andej, — tregoi babai dhe mbushi gotat me raki. — Gëzuar e mirë se na erdhe!

— Gëzuar! — tha daja.

— E mora me mend, — tha nëna, — derisa ra këtu, kushedi ç'ka bërë andej!

Një grimë herë nuk foli njeri. Pastaj u dëgjua zëri i dajës. Çudi, ashtu si mua ajo ngjarja në mal, edhe atij i ngeli mendja te dëbora.

— Vërtet kaq shumë ka rënë? — pyeti.

— Nuk mbahet mend si këtë radhë, — tha babai, — kanë shkuar për ndihmë edhe nga rrethe të tjera.

Daja e pa një çast me vëmendje. Pastaj vështrimi i menduar rrëshqiti nëpër dhomë dhe u përqendrua te një peizash me Alpet e Veriut, që babait ia kishte dhuruar një piktor i njohur. Kisha dëgjuar se piktorët e qytetit tonë shpesh u dhuronin miqve piktura. Heshtjen që zotëroi në dhomë e theu nëna.

— Lida, na këndo një këngë, — tha me zë të butë e ledhatues.

Të gjithë panë Lidën në sy. Ajo ngurroi një çast. «Ja kur të thotë tami se s'mund të këndoje pa orkestër», mendova. Por u dëgjua zëri i babait:

— Këndo, Lida, këndo!

Ajo u ngrit pak si me naze, po këngën e nisi mirë. Zërin e kishte të ëmbël. Kënga bënte fjalë për një fshat ditën kur kishin marrë dritën elektrike. Të gjithë e shihnin me gëzim, po veçanërisht daja. Sytë i shndritnin dhe ai herë pas here zinte me gishta mustaqet e holla e të zeza.

— Na kënaqe, të lumtë goja! — tha ai kur mbaroi Lida.

— Duhej edhe orkestra, — u shfajësua ajo. — Natyrisht, me orkestër do të tingëllonte më mirë.

Unë psherëtiva. «Ah, pse e prish tani, moj Lida!» — më erdhi t'i thosha. Kënga vërtet më kishte prekur. Ajo e kuptoi vështrimin tim dhe tundi kokën si të më thoshte se të nesërmen «do të ma tregonte qejfin mirë».

Pastaj hapëm televizorin dhe dëgjuam lajmet. Folësi njoftoi edhe për të-ftohtët e dëborën e madhe që kishte rënë në rrethet e Veriut. U dha dhe një kronikë e shkurtër, ku shiheshin traktorë që hapnin rrugët dhe pas tyre makina të shumta me ngarkesë. Ne shihnim në heshtje dhe të përqendruar. Një çast u ktheva nga daja. Ai dukej i vrenjtur, sikur diç sillte në mend.

Atë natë u bisedua gjatë e deri vonë. Po daja, pak nga pak, sikur e humbi gjallërinë. Herë-herë binte në mendime. Këtë ndryshim të papritur e vunë re edhe nëna, edhe babai.

— Ç'ke, mos të dhemb koka? — e pyeti ajo e merakosur. — Do një aspirinë?

— Jo, s'kam gjë. — Ai u përpoq të buzëqeshte, por në sytë e tij pashë një si shqetësim a brengë që e mundonte. Babai me nënën këmbyen një vështrim.

— Do na rrish ca ditë? — e pyeti babai.

— Si jo! — u hodh nëna. — Shërbimin e mbaroi, shokët i kanë thënë të rrijë deri në fund të javës.

Atë ditë ishte e mërkurë, kështu që deri në fund të javës... Nëna gëzohej për vëllanë, por edhe unë gëzohesha për dajën. Kisha qejf të rrinte sa më gjatë. Do të dilnim bashkë në qytet, do të bënim fotografi dhe pastaj ai do t'ua tregonte fëmijëve atje, në fshatin e largët me dëborë.

— Ke kohë që s'na ke ardhur, rrallë e për mall! — tha babai dhe cakëroi gotat. — Pi një çikë, — e nxiti duke qeshur.

Daja bëri buzën në gaz dhe na ledhatoi përsëri mua e Norën. Pastaj filloi ta pinte rakinë ngadalë, i përqendruar. Çfarë ka daja? mendoja. Përse u shqetësua kështu papritur? Këto pyetje s'më hiqeshin nga koka e përpiqesha t'u jepja rrugë. Nganjëherë e shikoja vjedhurazi, si për të zbuluar të fshehtën që e mundonte. Më shkëputi nga mendimet nëna.

— Flini, fëmijë, vajti vonë për ju!

Ah, ku e gjeti! Po s'kisha ç'bëja dhe u shtriva në shtrat, megjithatë gjumi nuk më zuri. Lloj-lloj mendimesh më vërtiteshin. S'mbaj mend sa qëndrova ashtu, kur papritur dëgjova zëra që vinin nga kuzhina.

— Më vjen keq, po të ikësh. — Ishte zëri i nënës.

— Do të shkoj, moj Sofë, — thoshte daja. — Keq më vjen edhe mua, po më duhet të shkoj.

— Ka edhe të tjerë atje, vetëm nuk i keni lënë!

— Ashtu është, po... Ndoshta dhe unë nuk duhej të largohesha: dimër është dhe dimri s'ka karar, — tha me një ndjenjë qortimi për veten.

— Po ti erdhe për punë!

— Mund të vinte edhe ndonjë tjetër...

Unë mbaja frymën e prisja tërë ankth përfundimin e bisedës. Më vinte të qaja që do të ikte daja. Po përse, xhanëm? Kaq hall i madh ta kishte zënë?! Pastaj, ç'lidhje kishte halli i tij me stuhitë e dëborës?

— Po janë zënë rrugët, — ngulte këmbë nëna, duke kërkuar arsye për ta mbajtur të vëllanë. — Ti e dëgjove Bedon se ç'tha! Po fol, mor Bedo!

Pas pak biseda u ndërpre dhe unë dëgjova hapat e dajës, që hyri në dhomë lehtë. U shtri, por as ai nuk po flinte. Sillej herë në një krah e herë në krahun tjetër. Pastaj dhomën e ndriçoi flaka e çakmakut. Daja ndezi cigare. «E, të gjorat!» — m'u duk sikur psherëtiu. Mua po më mbylleshin sytë, por diç më mbante. Lëvizja nganjëherë e sustat e divanit kërcitnin. Por edhe krevati i dajës kërkëllinte vazhdimisht. Ashtu, në atë gjumë të trazuar, pashë në ëndërr veten dhe dajën në stan, në malet me dëborë. Një ujë i madh po i afrohej vathës. Herë fshihej e herë dilte në dritën e hënës. Ishte tinzar i madh. Ja, u afrua dhe... Unë iu hodha sipër duke klithur. Kur u hap drita, pashë se ajo që kisha kapur nuk ishte ujku, por Nora, motra ime e vogël. Ajo u zgjua e lebetitur. Të gjithë ishin zgjuar në shtëpi dhe po qeshnin me mua. Paskështa thirrur në gjumë: «Dajë, dajë!...»

Kur filloi të zbardhte, ndjeva që daja u ngrit

dhe pa zhurmë nisi të vishej. Do të ikte? Një si lëmsh m'u mblodh në grykë. Ngrita pak cepin e jorganit dhe e pashë vjedhurazi. Sytë i kishte disi të buhavitur, ndryshe nga një natë më parë. U ngri-tën edhe nëna e babai.

— Domethënë e vendose? — tha babai.

Nëna e shihte me dhembshuri, e ndihmoi të vishte pallton e madhe prej shajaku dhe diçka i futi në torbë. Daja u bë gati. Pa edhe një herë nga dhoma i menduar, pastaj iu afrua krevatit ku flinte Nora. Dëgjova që puthi motrën e vogël në faqe. Pastaj ai erdhi pranë meje. Më dinte në gjumë. Unë, nën jorgan, mezi po mbaja ngashërimin. Ai zbuloi pak cepin e jorganit dhe buzët e tij ma ngrohën ballin. Nuk u përmbajta: më mbytën ngashërimet dhe ia hodha krahët në qafë.

— Dajë, përse po ikën, përse? — i thosha.

Kjo i erdhi e papritur. Pa një çast nga nëna dhe babai.

— Do të shkoj te delet, Titi, — më tha. — Ato më presin. Kanë ftohtë, duan të hanë, — foli ngadalë, si të donte të më mbushte mendjen se i duhej të shkonte patjetër. Por unë nga fjalët e tij nuk u binda.

— Do të vij përsëri, — më tha atëherë, duke dashur të më qetësonte. — Do të vij kur të shkrijë dëbora.

Ah, kujt ia thoshte këtë! Po unë tani e dija se dëbora në fshatin e tij nuk shkrinte gjatë tërë dimrit, ndërsa behari... Ohu, behari ishte larg. Në shpatulla ndjeva krahët e tij. Më kishte pushtuar fort.

— Delet janë bërë me qengja, Titi, — më tha prapë. — Kafshë janë, të gjorat, dhe të flasin nuk dinë. Por, ama, për të njohur më njohin dhe më duan pranë... Hë, si thua tani?!

Pak çaste më vonë ai po largohej. Përfytyrimi përsëri më çoi atje larg, në stan, ku delet kishin pjellë qengja dhe më vinte mirë, që edhe ato e donin dajën tim!

JO, NUK ISHTE AI

Me Drinin jemi shokë të ngushtë. Njihemi që prej disa vjetësh, kur shkova të punoja në fonderinë e uzinës. Jemi gati të një moshe, rreth të njëzetepe-save. Ai ka trup mesatar e të lidhur dhe në fytyrën pakëz të rrumbullakët, te sytë e zinj, sikur i digjet vazhdimisht një si zjarr i lehtë dashamirësie.

Një pasdreke, ndërsa shëtitnim në kodrat e qytetit, Drini nxori nga xhepi një tufë letra. Nuk e pyeta, se e hapi vetë bisedën:

— I shikon këto? I kam nga shokët. Me disa kam qenë në shkollë, me disa të tjerë kam kryer shërbimin ushtarak. U deshëm dhe na u bë zakon të këmbejmë letra.

U ulëm diku dhe ai foli prapë.

— Ja, këtë e kam nga një shok me të cilin kam punuar disa muaj në aksion, në hekurudhë. Kam kohë pa e takuar dhe më ka marrë malli. Çudi, s'të kam folur ndonjëherë për të, ë?

— Jo, — i thashë.

— Eh, çfarë shoku! — psherëtiu ai disi i mallëngjyer.

Letra ishte e shkurtër. Shoku pyeste për shëndetin, i kujtonte aksionin dhe mbrëmjet që kishin kaluar, pastaj i linte porosi për një stof, që ai s'po e gjente në Tiranë. Ndërsa Drini lexonte, unë e kundroja në heshtje dhe më bënte përshtypje ajo psherëtima e tij që përsëritej e ndezur prej mallëngjimit të singertë.

Kur mbaroi, u kthye papritur dhe më pa drejt në sy:

— E di ku kemi punuar?

Unë ngrita supet dhe buzëqesha, sepse, natyrisht, nuk kisha nga ta dija.

— Tek ura, — tha ai gjithnjë entuziast. — Tek ura e madhe e Bushtricës, — plotësoi pastaj.

Dhe menjëherë nisi të fliste për një natë betonimi, kur plintat e urës ishin përmbytur dhe ata, bashkë me shokë të tjerë, kishin punuar brenda në ujë.

Vetiu m'u ngjall njëfarë interesi për shokun e Drinit.

— Si e quajnë? — e pyeta.

— Petrit, — u përgjigj me zë të ngrohtë.

— Po ku ndodhet tani ai Petriti yt me flatra? — e ngacmova.

— Eh, — psherëtiu ai, — tani është inxhinier dhe punon në një uzinë në Tiranë. Kështu kam

marrë vesh, se vetë, siç të thashë, kam kohë pa e takuar.

Ndoshta, me kalimin e kohës, biseda e Drinit do të më shuhej nga kujtesa, por një ndodhi e kohëve të fundit më bëri ta sillja ndër mend.

Së bashku me Drinin udhëtonim për në shtëpinë e pushimit në Durrës. Ishte treni i mëngjesit dhe në platformë kishte shumë udhëtarë. Në Rrogoshinë, në vagonin tonë hipën përsëri udhëtarë të tjerë. Befas Drini u ngrit. Pashë si ngazëlleu në fytyrë dhe thirri duke u shkëputur disa hapa:

— Petrit, o Petrit! — Nuk priti më dhe u hodh në krahët e një djaloshi, që kishte gati moshën tonë.

Ai ishte veshur me shije dhe flokët e ndarë anash i shkëlqenin.

«Qofsha i gabuar, i thashë vetes, sepse...» Jo, ndoshta nuk ishte e vërtetë, por mua m'u duk ashtu, m'u duk sikur, në krahasim me entuziazmin e Drinit, ai tjetri...

— Po hajde ulemi bashkë, — dëgjova zërin e Drinit.

— Jam i shoqëruar, — tha Petriti dhe bëri me kokë nga një grua e re, që buzëqeshi me përzemërsi.

— Pa shih, më duket se janë tamam dy vende të lira te ne, — ngulmoi Drini.

Ai tjetri pa menjëherë nga unë dhe qeshi:

— Dihet ajo punë, njerëzit që duhen i do edhe fati.

— Epo mirë, shkojmë, Petrit, — i tha gruaja.

Ata erdhën te ne. Ai më përshëndeti me kokë dhe nxori shaminë për të fshirë pluhurin e ndenjës...

Drini kishte në fytyrë gjithnjë atë shprehjen e

ngazëllimit dhe, bënte ç'bënte, nuk ia ndante sytë.

— Po ç'kemi, si jeni? — e pyeti për të dytën a për të tretën herë. Drini e zinte dhe me dorë kur fliste, sikur të donte ta sillte nga vetja e ta shihte më mirë. Ndoshta kjo shkaktonte njëfarë bezdie, sepse pashë Petritin që në një çast i hodhi një vështrim të çuditshëm.

— Po ju ku punoni? — pyeti gruaja Drinin.

— Në uzinë, fonditor.

— Atje ku ke qenë? — tha Petriti.

— Po, atje. — Pastaj Drini u kthye nga gruaja, sikur ta ndiente për detyrë t'i shpjegonte asaj: — Kemi qenë bashkë në aksion dhe kemi kaluar mjaft mirë. Atëherë Petriti ishte në shkollën e mesme. A të kujtohen ato ditë? — i rrahu shpatullat. — Hajde, hajde, si kemi kaluar, mor Petrit! — Dhe Drini përsëri i rrahu shpatullat shokut.

— Vërtet, vërtet, — ia bëri tjetri. Kësaj ra dhe u duk sikur kujtimi i diçkajë të bukur ia përqëndroi vështrimin në një pikë. Por, pas disa çastesh, ngriti dorën dhe përshëndeti nga fundi i vagonit.

— Kush është? — pyeti gruaja.

— Një shok, — tha ai.

Nuk vonoi shumë dhe erdhi para nesh një djalosh i ri, me trup të bëshëm e fytyrëkuq.

— Ç'kemi, o Petrit, si je? — Të dy u puthën dhe u përqaftuan.

— Nusja, — prezantoi Petriti gruan e re dhe pastaj paraqiti të ardhurin. — Është një shoku im, kemi mbaruar bashkë fakultetin. Por ky e tradhtoi inxhinierinë, tani është gazetar.

Tjetri buzëqeshi.

Unë e ndiqja me sy Petritin dhe prisja që tani të na prezantonte ne me atë shokun. Ndofta harroi, më shkoi nëpër mend. Ndërkaq Petritit s'iu durua e filloi të fliste, të pyeste për disa shokë, se ku gjendeshin, nëse i kishte takuar ai gazetari apo jo...

Pashë një çast me bisht të syrit nga Drini. Përpiquej ta zotëronte veten, po një damar i hollë sipër vetullës së djathtë sikur i dridhej. Doja ta nxirrja nga ajo gjendje. Duke vështruar pejzazhin nga dritarja, i thashë.

— Kohë e mirë duket.

— Po, — mërmëriti dhe ai. Po sepse nuk guxoi të më shihte në sy. Më tej s'na eci. Ndërsa ata, një copë herë vazhduan të flitnin me gjallëri.

Gazetari me siguri na mori për udhëtarë të rastit dhe s'na kushtoi vëmendje. Megjithatë, kur nxori paqetën, na zgjati cigare edhe neve. Pastaj i kërkoi leje Petritit.

— Kam motrën përpara e po ngrihem. Do të kisha ndenjtur me gjithë qejf. Po sikur... — U kujtua për diçka, por nuk e çoi fjalën deri në fund. — Vini të rrimë bashkë? — pyeti pastaj.

Gruaja e re pa nga Petriti dhe i bëri me sy nga ne. Dukej që nuk i vinte mirë të ngriheshin.

— Po ja... — mërmëriti Petriti.

— Shkoni, shkoni, — foli Drini si i zënë ngushtë. — Ne do të zbresim pas pak, — u përpoq ta lehtësonte pastaj.

Po e ndiqja me sy Petritin. Ndoshta ai e ndjeu vështrimin tim, sepse shpejtoi:

— Epo... Ju uroj gjithë të mirat!

— Mirupafshim! — u përgjigj Drini.

— Mirupafshim! — u dëgjua edhe zëri i ngroh-

të i gruas së re, që, siç m'u duk mua, na buzëqeshi me ndjenjën e njeriut fajtor.

Drini u ul. Një kohë të gjatë bëri sikur merrej me kopsat e këmishës. Nga dritarja vinte si me vrap era e fushës. Fushën e kishte mbuluar gjelbërimi i grurit. Isha i bindur se të dy mendonim për të njëjtën gjë. Po prita edhe pak. Pastaj e pyeta, pa fshehur njëfarë ironie:

— Ky ishte Petriti?

Ai iu shmang vështrimit tim. Në profil i shikoja vetëm një pjesë të fytyrës, ndërsa duart nuk i hiqte nga kopsat e këmishës, që sikur do t'i këpuste.

— Jo, nuk ishte ai, — foli ngadalë.

Më pas e ruajtëm të dy heshtjen. Njëherë provova të lexoja, por nuk përqëndrohesha dot. Ndofta s'ishte ndonjë gjë e madhe kjo që ndodhi, por... Vërtet, ky të jetë Petriti që Drini e donte aq shumë? — pyesja veten. — Apo mos vallë Drini s'e ka njohur mirë?...

Ngrita sytë nga Drini dhe u përpoqa ta gjeja përgjigjen e këtyre pyetjeve në fytyrën e tij. Por ai vazhdonte të rrinte i menduar.

PRAPË NË KANTIER

Kur u gjend në oborrin e gjerë të kantierit, Agimi hodhi një çast vështrimin rreth e qark, si të donte të orientohej, dhe nisi të ecte me hap të shpejtë, duke parë me mall objektet e shumta që ngriheshin njëri pas tjetrit. Dielli i nxehtë, që flakëronte në qiellin e pastër pa një re, bënte të shkëlqenin pjesët metalike të objekteve dhe krahët e vinçave-kullë. Tej, mbi disa objekte të papërfunduara, gjithçka ndriste nga dritat verbuese të saldatriçeve. Punonin montatorët.

Ai kishte një kohë të gjatë pa u parë me shoqët. I kujtohej se, kur kishte ardhur njëherë me leje, mjeshtri e kishte pyetur përse s'ishte dukur kohët e fundit.

«Kemi shumë mësimë», i qe përgjigjur ai, pa guxuar ta shihte në sy. I qe dukur sikur mjeshtri do t'i thoshte: «Edhe një vit më parë kishe mësimë, por vije, ama!» Po mjeshtri nuk e kishte ngacmuar.

Ndërkohë po i afrohej njërit nga objektet më të mëdha. Ca montatorë zbritnin që andej me fytyra të djersitura, ndërsa sipër, disa të tjerë vazhdonin të saldonin. «Ata janë», tha me vete dhe u bind kur dalloi trupin e madh, pak të kërrusur të mjeshtrit që saldonte mbi një tubacion të lartë. Rrotull tij ishin shpërndarë «djemtë», siç i quante ai shokët e brigadës. Ata ishin gati moshatarë me Agimin.

Nisi të ngjiste shkallët e hekurta dhe pas disa çastesh u gjend pranë mjeshtrit.

— Puna mbarë, mjeshtrë!

Ai ngriti sytë e mëdhenj e të zinj. Në ta sikur feksi menjëherë një shkëndijë e veçantë drite.

— O, mirë se erdhe, Gimi! — i foli mjeshtri.
— Po i dhe provimet apo nuk i dhe, ç'kemi ndonjë të re, mor djalë?

— Mirë, mirë. — Agimi vuri buzën në gaz.
— Edhe provimet i dhashë.

— Ashtu de! — u kënaq tjetri. I hodhi një vështrim orës e tha prapë: — Ja, të mbaroj këtë që kam nisur dhe do të zbresim. Ora e pushimit erdhi.

Agimi pa shokët që punonin më larg dhe hodhi përsëri sytë nga mjeshtri. Një frymë ere e lehtë i shpupuriste flokët e rrallë dhe të zbardhur nga puna. Në fytyrën e përcëlluar nga dielli dukeshin dy rrudha të thella. Shenjat e pleqërisë, mendoi Agimi dhe bëri padashur buzën në gaz. Iu kujtua se

mjeshtrit nuk i pëlqente t'i thoshe që po plakej. Njëherë, sekush i tha ashtu dhe ai ia mori për ters. Asnjëri nuk e dinte me siguri përse u zemërua mjeshtri dhe përse u bë i heshtur disa ditë. Dikush tha se i kishin ardhur fëmijët vonë dhe, meqenëse të voglin e kishte ende në tetëvjeçare, nuk i pëlqente t'i kujtonin pleqërinë. Këtë gjë ia kishte thënë më vonë Agimit në intimitet, por e kishte vënë të betohet, dhe punëtori i ri ia ruante të fshehtën që i kishte besuar mjeshtri.

Pas pak zbritën nga objekti dhe u gjendën të rrethuar nga një grup montatorësh. Batoja, një djalosh trupvogël, iu hodh në qafë, dhe filloi ta puthte, siç e kishte zakon t'i përqaftë shokët kur ndahet të shtunave.

— Hajde, inxhinier, hajde! Po na harrove fare kësaj radhe!

Mjeshtri i shihte me bisht të syrit dhe sepse i vinte mirë që «djemtë» përqafoheshin ashtu. «Vërtet që ky shejtani sikur na ka harruar ca, se, ndryshe, do të vinte më parë për të na takuar, po s'ka gjë!» — tha me vete.

— Po si jeni? Si ju shkojnë punët? — pyeste Gimi, i prekur.

Kur pa edhe disa vajza montatore, ktheu sytë nga mjeshtri me njëfarë habie dhe mërmëriti: «Qenka bindur, më në fund!» Më parë, kur i thoshin se në kantieret e tjera kishte plot vajza që punonin si montatore, mjeshtri përgjigjej i zënë ngushtë: «Jo se nuk e bëjnë dot, xhanëm, po atje lart mbi objekt e kanë të vështirë. Pastaj sesi...»

— Hë, more, e hodhe atë lumë! — qeshi mjeshtri, si të kuptonte mendimet e djaloshit dhe u

buzëqeshi vajzave: — Ju s'e njihni Agimin, ka punuar këtu. Tani vazhdon vitin e dytë të inxhinierisë mekanike.

— Mjeshtri tani s'ka vetëm djem, — e ngau njëri prej montatorëve.

— Po edhe atyre djem u thotë. Harron, — shtoi Batoja, duke i shkelur syrin Agimit.

— Sus, more! — bëri sikur iu kërcënua mjeshtri dhe të gjithë qeshën së bashku.

— Do të rrish ditë, Gimi?

— Jam me pushimet e verës dhe erdha t'ju shoh.

— Hajde të hash bukë, — e ftoi mjeshtri, kur u ulën dhe të tjerët.

— Falemnderit, kam ngrënë, po s'po jua prish.

Pas pak Gimi pyeti:

— Po Landi ku qenka?

Ndoshta ata e prisnin këtë pyetje. Mjeshtri ngriti kokën dhe, ndërsa të tjerët heshtnin, ai u përpoq ta hidhte me dy fjalë:

— E kemi ca të sëmurë... Po s'ka gjë të madhe, — shtoi menjëherë. — Mirë është, apo jo, mor djem? Tani ka dalë nga spitali dhe rri me raport në shtëpi. — Po kur pa se me këtë fjalë më tepër e ndezi, sesa e shoi merakun e Agimit, vazhdoi. — Ndoshta para dy javësh. Ishim duke montuar njëren nga ato pajisjet, — ia bëri me dorë nga një cilindër i madh metalik që ishte mbështetur mbi dy këmbë të larta betoni. — Na duhej ta montonim shpejt, sepse pengonte punën. Mirëpo nuk po puthitej mirë. Më hipën dhe i fola ca si rëndë Landit, që kishte punuar aty. Atë ditë u larguam të mërzhitur dhe as që vumë re se Landi nuk erdhi me ne. Në mëngjes pamë

se cilindri ishte montuar, ndërsa Landin e gjetëm në dhomën e punonjësit të shërbimit. E kuptuam menjëherë se ç'kishte ndodhur. Ai kishte punuar tërë natën. Kur na pa, u ngrit si i zënë në faj. Vura re se krahun e djathtë sikur donte ta fshihte. Pa të, i thashë, ulu në tryezë dhe hajde t'i thyejmë krahët, provojmë kush i ka më të fortë... Ishte aksidentuar dhe, kuptohet, duhej ta çonim në spital. — Mjeshtri heshti dhe pa nga Agimi, si t'i thoshte: «Ja, kjo është e gjitha.»

Për disa çaste asnjëri nuk foli. Era binte me vete zhurmën e vinçave dhe zërat që vinin nga objektet. Mjeshtri u ngrit. Kishte filluar të ngjitej mbi konstruksion, kur njëri nga djemtë tha:

— Kontrollon punën. E ka bërë zakon sa herë që bëjmë pushim. Më vjen inat nganjëherë, se më duket sikur nuk ka besim te ne.

Agimi e ndoqi për disa çaste me sy tek hipte mbi konstruksion dhe pastaj vështrimi i humbi diku midis objekteve. Iu kujtua Landi me ato tiparet e mprehta, që zbuteshin disi nga butësia e syve të kthjellët. Kur kishte ardhur për herë të parë, mjeshtri i kishte thënë:

«E shikon këtë, — dhe i kishte treguar Agimin. — Ky do të të mësojë profesionin e oksigjenistit, prandaj hap sytë dhe dëgjoje! — Pastaj i ishte kthyer Agimit: — Shiko, ta mësosh dhe mos e bëj si ustallarët e dikurshëm, që s'të jepnin zanat.»

«Mos ki merak, mjeshtrë.»

Landi mësoi të punonte si oksigjenist dhe, kur Agimi do të nisej për në fakultet, mjeshtri i tha:

«Gimi, ti, po munde, merr diplomën e inxhinierit, se Landi e mori atë të oksigjenistit.»

— Po kush e bën tani punën e Landit? — pyeti Agimi. — Ai është oksigjenist dhe...

— Tani për tani vetë mjeshtri, — tha Batoja. — Punojmë edhe ne nga pak, po ti e di, punët këtu kërkojnë njeri të specializuar. E sheh edhe vetë, more Gimi, ngado ndërtohet.

— Gati, djema! — u dëgjua zëri i mjeshtrit. Ai ia bëri me shenjë Agimit dhe kjo do të thoshte se do të punonin bashkë. Ai hapi një kasafortë metalike dhe i zgjati një kuti, që djaloshi e njohu menjëherë. Ishin veglat e tij të punës, me të cilat tani punonte Landi.

Pas disa çastesh, kanella e oksigjenit u mbështet e bindur mbi metal. Tek shihte flakët verbuese që ndriçonin përreth, Gimi ndjeu se diçka prej asaj ngrohtësie po i depërtonte në trup. Mbase ishte malli, dashuria për profesionin. Ai kishte kaluar disa vjet kantiereve dhe nuk i kishte shkuar ndonjëherë në mend se do të vinte një ditë që do të ndahej prej tyre. Por ja, punët erdhën ndryshe. Mbaroi shkollën e mesme pa shkëputje nga puna dhe shokët ngulën këmbë të vazhdonte studimet e larta.

— Hë, Gimi, si shkon puna? — Mjeshtri qëndronte në këmbë, pranë tij.

— Këtu mbarova. Mbase...

— Hë, qerrata! — qeshi mjeshtri. — Kush tha se mbarove? Do të vazhdojmë bashkë, ja, mbi atë tubacionin atje lart.

Ata nisën të ngjitnin shkallët.

— Kur do të mbarojë objekti, mjeshtër?

— Zotimin e kemi për brenda muajit. Fjalën e

kemi dhënë e tani vrasim mendjen se duhet mbajtur, mor bir.

— Po do t'ia dilni? Duket, punë ka shumë.

Mjeshtri s'foli. Ajo rrudha e lehtë që iu formua në ballë, ndoshta fliste më shumë... Agimi mbështeti kanellën mbi metal dhe përsëri përreth shkëlqeu flaka verbuese. Edhe atij vetë sikur po i kristalizohej një mendim. Plazhi, shëtijtjet, pushimet... Një mbrëmje, ndërsa studionte në dhomën e konviktit, i kishte shkuar nëpër mend se nuk do të bënte keq sikur verës... Hëm, e çfarë verës? «Epo!» — foli me zë, sikur po i përgjigjej një pyetjeje.

— Ç'pate, Gimi?

— Asgjë, mjeshtrë.

Më pas ata punuan në heshtje.

Atë ditë brigada punoi deri vonë.

— Çka! Po të vazhdojmë si sot, jemi në rregull me zotimin, — tha mjeshtri kur po dilnin nga kantieri.

— Vërtet, bëmë goxha punë, — u hodh njëra nga vajzat.

— Nesër do t'u themi shokëve të brigadës tjetër të na dërgojnë oksigjenistin. Vjen edhe ai e pastaj...

— Po kushedi a na e dërgojnë nesër. Ata s'kanë mbaruar akoma kolonat, mjeshtrë, — tha Gimi. Pastaj shtoi: — Po të mos keni ndonjë kundërshtim...

Ai ngurroi një çast.

— E çfarë ti, more student? — e pyeti Batoja.

— Po ja, a nuk jam edhe unë oksigjenist? Vaj me ju ca kohë, sa të dalë Landi në punë. Me pushime jam dhe zëre se...

— Ta gëzosh kostumin, student! — e ngacmoi

Batoja. — E ke hak të bësh një kostum të ri për në shtator. Dhe paratë e stofit i nxjerr me një pesëmbëdhjetëditësh se, helbete, të kemi edhe si gjysmë inxhinier...

Gimi ndjeu se dikush i ra lehtë me bërryl në brinjë. Ishte mjeshtri. Ai po i buzëqeshte. Dhe në gjestin e buzëqeshjen e tij kishte diçka ndjellëse e afruese, tamam si atëherë, kur Banush Jera, brigadier i pesëdhjeteshtatëvjeçar, i kishte besuar të fshehtën e pleqërisë. Në krah të mjeshtrit djaloshi sepse e ndjeu veten të shpërblyer.

LISI

Çeloja shoqëroi me sy grupin e të plagosurve dhe u qetësua vetëm atëherë, kur siluetat, që mezi shquheshin nën hënë, i humbën nga sytë. Të plagosurit kishin hyrë tashmë në luginën me lisa të dendur.

Kishte kaluar mesi i natës. Midis degëve dhe gjetheve të lisave dukej qielli i pastër, e gjithë ai gjelbërim sikur ishte stërpikur me kaltërsi. Një erë e lehtë bënte të fëshfërinin bari dhe kaçubet përrreth. Tej, nga gërmadhat e fshatit që digjej, ngriheshin shtëllunga të zeza tymi. Të xhindosur nga humbjet që kishin pasur me batalionin partizan, nazistët në fshat po derdhnin mllëfin e tyre. Dikush u kishte treguar se në një nga shtëpitë ishin stre-

huar partizanë të plagosur. Ata ishin drejtuar andej, por Çeloja kishte mundur të siguronte në kohë tërheqjen e shokëve...

Krismat e armëve sa vinin e dëgjoheshin më qartë. «Do të kenë ndonjë bukëshkalë me vete që u tregon shtigjet!» mendoj ai. I duhej një pozicion më i mirë. Disa metra larg vendit ku ndodhej, atje ku lugina ngushtohej, ngriheshin disa shkëmbinj e midis tyre një lis më i lartë nga të tjerët. Ishte një lis i mocëm, me degët e hapura anash, me zgavra të mëdha e të errëta. Pa humbur kohë, vajti te lisi. Zbathi opingat, i futi në xhep dhe nisi të kacavirrej në trungun e trashë.

Krismat tani dëgjoheshin më pranë. Çeloja u ngjit, më në fund, në pikën ku lisi ndahej në dy degëzime të mëdha dhe, si sajoi një dritare midis gjethëve, u mbështet në njërën anë të trungut. Fshati vazhdonte të digjej. Vendi, disa qindra metra rreth e qark, ndriçohej nga gjuhët e flakëve. Një pështjellim hakmarrjeje dhe zemërimi i grafulloi Çelos. Me duart e ashpëruara nga parmenda, shtrëngonte fort automatikun. Hera-herë, ndërsa përgjonte në heshtje, nga gjethet i binin në qafë pika vese. Përtej gjethet shkundeshin prapë dhe frushullonin ngadalë... Ata po vinin. U shfaqën përtej lisave. Qëllonin kuturu dhe herë pas here qëndronin. «Le të afrohen edhe pak!» — tha me vete. Dhe hijet e para ia behën drejt lisit: Një... dy... ja dhe i treti. As pesëdhjetë metra nuk i kishte larg. Çeloja shtrëngoi këmbëzën e armës dhe mbajti frymën; ushtarët e huaj ecnin ngadalë, duke u fshehur mbrapa trungjeve dhe shihnin nga të katër anët me një ndjenjë pritjeje. Hesh-tja, errësira dhe ai pyll i dendur lisash sikur u ngjall-

nin tmerr. Ushtarët e parë shihnin majtas e djathtas dhe dukej sikur diçka i belbëzonin njëri-tjetrit. «E ruani kokën, ë! Po të vritni pleq e fëmijë, jeni trima ju! Ç'bëtë në botë, more derëzinj? Mbolle vdekjen, mor gjerman mavria!...» Disa breshëri të shkurtra dhe një hije u plandos. Çeloja përkëdheli me sy tytën e automatikut. Përnjëherësh një zhurmë krakëllitëse mbuloi pyllin. Një mitraloz zuri të rrihte në tym shkëmbinjtë. «Bjeri, more, bjeri!» — thirri Çeloja. E ndiente se pas pak, ata do të zbulonin pozicionin e tij dhe... Të paktën t'i mbante sa më gjatë të gozhduar në luginë, sa të dilnin nga rreziku partizanët e plagosur. Pastaj... «Do të kujdesesh për shokët. Pas betejës do të vijmë ne t'ju marrim», — kishte thënë komandanti. Kur mendoi se do të qëndronte duarkryq, u pezmatua, po nuk e dha veten. Detyrë ishte detyrë dhe ai duhej ta zbatonte. Tashmë ai e kuptonte përgjegjësinë që kishte. Në krah të djathtë i tërhoqën vëmendjen dy hije të tjera. Atë zvarriteshin ngjitur me tokën dhe Çelos se si i vinte: le, po kërkonin edhe t'ia hidhnin ashtu! E ku, në atë luginë ku ishte rritur dhe që e njihte me pëllëmbë. Jo, mor, jo! i erdhi t'u thërriste. Po nuk foli, vetëm vuri automatikun në punë me breshëri të shkurtra. Atëherë zjarri u dendësua: gjethe dhe purteka filluan të koriteshin nga plumbat. Çeloja u mbështet njësh me trungun.

Mëngjesi po vinte me një gushë drite të kthjellët. Era, që frynte deri atëherë, sikur po fashitej ngadalë. Breshëria e armëve vazhdonte me të njëjtin ritëm. Një therje të mprehtë ndjeu në këmbë. Hoqi gishtin nga këmbëza e armës dhe vuri dorën mbi plagë. Pëllëmba iu lag me gjak. Për një çast

mendoj se mos e kishin diktuar, por, kur pa që plumbat qëllonin më poshtë, u qetësua. «Plumb qorr ky, — tha me vete. — Do t'i mbaj të gozhduar. Ndoshta shokët e plagosur tani kanë kaluar matanë». Ata ishin katër partizanë, një partizane dhe mjeku. Partizania ishte plagosur rëndë. Atë e mbanin në vig mjeku dhe një nga shokët që ishte plagosur më lehtë, ndërsa dy të tjerët me zor ecnin dhe vetë.

Kur Çeloja u tha se do të mbulonte tërheqjen, ata nuk kishin pranuar ta linin vetëm. Mirëpo vendimi duhej marrë shpejt, se koha nuk priste. Çeloja mori Agon mënjanë. «Epo dikush duhet ta mbulojë tërheqjen, — i tha. — Këtë unë e bëj më mirë, se jam shëndoshë dhe se luginën e njoh me pëllëmbë. Hajde, ç'dreqin të ka hipur kështu, të më kundërshtosh, mor vëllako!? Nuk ke besim tek unë, a si?» — deshi ta prekte në sedër. U hëngrën dhe një grimë herë, pastaj grupi i të plagosurve u nis...

... Papritur, krismat e armëve pushuan. Nazistët po hynin në formacion luftimi në luginë. Ecnin me kërcime dhe herë-herë qëndronin një çast për të përgjuar. Dhe kushedi përse, duke tërhequr këmbëzën e automatikut, Çeloja shtrëngoi dhëmbët. Kishite një mllef të madh në zemër. Disa ushtarë u shtrinë barkas, të tjerë filluan të zvarriteshin përsëri. Po ai e shihte si në pëllëmbë të dorës. «Jepi, Çelo, jepi!» Dhe qëllonte e qëllonte. Po tani e kishin zbuluar. «Vritem për lirinë, për Atdheun, për shokët... Të rrojë Partia!» — tha komisari, kur ra në fushën e betejës.

Lugina jehonte. Mbi degët e lisit plumbat binin breshëri. Po që nga lisi i moçëm, si prej një llogoreje të vërtetë, edhe partizan Çeloja përgjigjej me

zjarr. Sa armiq kishte parë ai lis! Sa herë i ishin përcëlluar degët! Por kishte qëndruar i fortë nëpër mote, me rrënjët thellë në tokë. Rreth tij ngriheshin lisa të tjerë, të rinj dhe të shëndetshëm.

Duke parë si afroheshin armiqtë, Çeloja vërviti njëren pas tjetrës dy bomba. Përballë u ngrit një perde tymi, përzier me dhera e cifla gurësh. Atëherë rrëshqiti më shpejt nga trangu dhe u gjend midis shkëmbinjve. Një plumb i nxehtë i fshiku ballin. Vuri pëllëmbën, gjaku po i binte në sy e në fytyrë. «Gjallë jam, — mërmëriti dhe përsëri hodhi vështrimin rreth e qark. — Ke akoma hak për të marrë, o Çelo! Gjaku i komisarit nuk shpaguehet lehtë!»

Ndërkohë nazistët pandehën se e vranë partizanin, por mbetën të zhgënjyer. U ndodhën përsëri përballë zjarrit të tij. Çeloja ishte plagosur për të tretën herë. Çurgu i gjakut i skuqi bluzën... Paq pak ndjeu se sytë po i erreshin. «Ç'ke kështu, o Çelo!» — i dha zemër vetes. Sikur po e zinte gjumi, sikur e nanuriste... «Ah, nënokja ime e mirë!» — mërmëriti. Kishte fjetur dikur në prehrin e saj, ja, si tashti...

Përpara syve hije të errëta që vinin rrotull si në një valle vdekjeje. U përpoq të vinte gishtin në këmbëz, por nuk mundi. «Janë ujq, Çelo, vraji, mos i lër të afrohen!» — i bëhej sikur i fliste nëna. Edhe komisari kështu i thoshte: «T'u biem bishave, Çelo, t'u biem.» Po dora nuk po i bindej më.

Armiqtë akoma stepeshin. Herë shihnin me habi e si të hutuar nga lisi e herë nga shkëmbinjtë. Ai i shihte si në mjegull dhe përpiquej të kapte armën. Papritur iu bë sikur dëgjoi një thirrje të njo-

hur, të dashur e të afërt: «Para, partizanë! Para, partizanë!» Zërat e shokëve. Po vinin. Ata patjetër do t'i shpëtonin shokët e plagosur. E mblodhi veten një çast. Në mënyrë të pavetëdijshme lëvizi dorën mbi gjerdan dhe gishtërinjtë i prekën diçka të ftohtë. Diçka të ftohtë por që e ngrohu. Ai s'do t'i linte armiqtë të kalonin në luginë. Gjithçka përreth shkëlqente. Rrezet e diellit çanin midis gjetheve. E hoqi me mundim siguresën dhe, pas një grime, gjithçka u pështoll nga tymi. Si nëpër ëndërr dëgjonte se të tjera granata binin andej, nga ishte armiku. Pastaj... «Çelo, Çeloooo!» — e thërrisnin. «Çelo, Çeloooo!» — jehonte lugina. Një buzëqeshje iu ravijëzua te cepat e buzëve dhe sytë ia përshkënditi dielli... Pak më tutje, lisi sikur mermëriste diçka me gjethet e pranverës.

F T E S A

Nëpunësi i shërbimit i tha se Remziu ishte në mbledhje dhe Bardhi vendosi të priste. Filloi të bënte tutje-tëhu nëpër një korridor të gjatë. Shihte stendat me pamje nga ndërtimet në vendin tonë dhe mendonte për takimin me shokun. Remziu patjetër do të gëzohej kur ta shihte. Të dy do të shëtisnin një copë herë dhe, po të ishte i lirë Remziu, mund të këmbenin edhe ndonjë mendim për projektin që atë mbrëmje.

Punonjësit e institutit po dilnin nga salla e mbledhjeve. Midis tyre njohu Remziun. Kishte veshur një pardësy kafe dhe një kravatë në ngjyrë të kuqe. Pak çaste më vonë u takuan. Remziu sikur ishte bërë më i mbushur, i kishte rënë një i kuq

shëndeti në fytyrë. Por, siç iu duk Bardhit, në ato çaste sepse dukej i mërziur. Dolën në bulevard. Dielli ishte në të perënduar. Megjithëse bënte ftohtë, mjaft njerëz shëtinin.

— Si ia ke kaluar? — pyeti Bardhi.

— Mirë, mirë... Po ti? Flora si është?

— Të gjithë mirë jemi. Edhe Flora u rregullua: jep mësim në një fshat pranë kantierit.

— Mërziteni? — pyeti Remziu dhe e pa si me keqardhje.

— Nuk ankohe mi. Në përgjithësi kalojmë mirë. Së shpejti presim fëmijë. — Fytyra e Bardhit mori një shprehje të ëmbël. Heshti një çast, buzëqeshi dhe pastaj vazhdoi: — Nganjëherë mblidhemi me shokët e kujtojmë vitet që kaluam në fakultet.

Vështrimi i Remziut u bë i ngrohtë.

— Si janë shokët? — pyeti butësisht.

— Të fala të bëjnë. Të kujtojmë shpesh.

— Domethënë e kaloni mirë?

— U mësuam, na duket sikur kemi qenë gjithmonë atje. Nuk e mendonim kështu kur ishim në fakultet.

— Natyrisht, — pranoi Remziu. — Hëm, qenke frymëzuar! — shtoi pastaj. E qeshura i mbeti vetëm një çast në buzë. Ajo hija e mërziut i kaloi prapë në fytyrë dhe herë-herë sepse kapte vetullat me gishta.

Ndodheshin përballë Pallatit të Madh të Kulturës. Përreth ndihej gjallëria e madhe. Autobusë urbanë dhe makina të vogla lëviznin nga të gjitha anët. Kur vinin te sheshi, jepnin sinjale dhe humbisnin nëpër rrugët që përshkojnë kryeqytetin.

— Sot fillon festivali, — foli papriur Remziu me zë të menduar e që shprehte keqardhje.

Bardhi futi dorën në mënyrë të vetvetishme në xhep. «Meqë do të shkosh në Tiranë, shiko edhe festivalin», i kishin thënë shokët, kur kishte hipur në autobus. Dhe njëri prej tyre i kishte dhënë një ftesë. Por meqë e shihte shokun të shqetësuar, ndërroi mendje. Do të rri me Remziun, tha me vete. Ndërkohë tjetri kishte tretur vështrimin diku larg mbi kokat e njerëzve që shëtitnin, ndërsa buzët i mbante të mbledhura fort. Shëtitnin në heshtje.

— E di përse kam ardhur? — tha Bardhi.

Remziu e pa në fytyrë dhe ngriti vetullat. Bardhi ngurroi pak, pastaj foli:

— Ti e ke parasysh zonën e devijuar?

Tjetri pohoi me kokë.

— E, atje mendojmë të spostojmë aksin e trasesë rreth nëntëdhjetë metra dhe në kodrën përballë të hapim tunel. Kështu që... — Filloi ta ngrinte tonin, por, kur sytë i ndeshën në fytyrën e shokut, e qortoi veten se nuk kishte gjetur vendin dhe çastin e përshtatshëm për të biseduar për projektin.

— E' kupton, do të shkurtojmë qindra metra trase! — deshi ta shkurtonte bisedën.

Remziu e dëgjonte në heshtje dhe si me dyshim.

— Megjithatë, — shtoi Bardhi, — do ta shohim edhe nesër me shokët e tjerë, por mendova të këmbenim edhe bashkë ndonjë mendim. Ë, si të duket? — kërkoi një përgjigje.

— Mirë, mirë. Por mos jeni nxituar? Se edhe ata që e kanë projektuar, e kanë studiuar mirë vendin, — tha Remziu.

— Po unë prandaj kam ardhur.

Pasoi heshtja. Bardhi e shihte shokun si me

habi dhe sepse ndihej pakëz i fyer. Tjetri po shpjegonte përse nuk duhej të nxitoheshin:

— Para ca kohësh, — tha — kështu ndodhi edhe me projektin tim të një urë. Të mos e bëjmë kështu, se harxhojmë material e do kohë, thoshin, po ta bëjmë... Kur e panë mirë atë punë, të gjithë pranuan se ishin nxituar. Kështu që... — Remziu ngadalësoi hapat dhe e pa në sy Bardhin, si t'i thoshte: «Kështu e kanë këto punë!»

— Ne e kemi menduar mirë, Remzi, — tha Bardhi. Dukej se diç kishte filluar ta mundonte përbrenda, por e mbante veten.

Tjetri u përpoq ta zbuste zërin.

— E diskutojmë nesër në zyrë më mirë. Ë, si thua? — dhe psherëtiu thellë.

Ecën përsëri një copë udhë pa fblur, secili me shqetësimet e veta.

— Kohët e fundit s'na ke dalë, — tha Bardhi për të ndërruar bisedë. — Më porositi edhe Sadiku. Thuaji Remziut të na dalë, më tha.

Remziu tundi dorën në mënyrë të pakuptueshme. Pastaj qëndroi një çast, nxori cigaret dhe, duke shkrepur një çakmak të verdhë, foli disi i rënduar:

— Po më kritikon tashti?! Pak më thanë atje, — dhe bëri me kokë andej nga ishte salla e mbledhjeve. Në zërin e tij kishte një dridhje të lehtë.

Bardhi e pa në sy e heshti. «Qenka gjithë miza sot, tha me vete, apo mos e teprova edhe unë. Ky sikur e ka një hall.»

Filloi të frynte një erë e lehtë që e ftohu më shumë motin. Po binte muzgu i mbrëmjes dhe në

790

qiell tek-tuk ndritnin yje. Remziu ngriti jakën e par-dësyesë dhe sikur u mbyll më shumë në vetvete.

— Mirëmbërëma, Remzi! — përshëndeti një djalosh që u shkëput nga shokët me të cilët shëtiste.

— Mirëmbërëma, — murmuriti ftohtë Remziu dhe mblodhi vetullat.

— Akoma i zemëruar, ë?! — tha djaloshi dhe i rrahu shpatullat.

— Na lër të qetë, Pandi!

Tjetri i dha dorën Bardhit dhe në kalim shtoi:

— Një ishte, e shkreta, o Remzi. Po ty, më duket, të mërziiti më tepër kritika, sesa...

— Mirë, mirë, — ia bëri Remziu dhe vazhdoi të capitej.

— Për se e kishte fjalën ai? — pyeti Bardhi.

— Për ftesë, ftesë për festivalin.

— Për këtë je mërziitur ti? — Qëndroi dhe i vu-ri dorën në sup. Remziu s'foli, po në fytyrë dukej i zemëruar.

Bardhi sepse mori frymë thellë.

— Po e pate aq merak, ta gjej unë një ftesë, — tha duke parë orën. — Festivali akoma s'ka filluar.

Remziut sikur i ndryshoi fytyra. E pa me mosbesim shokun.

Bardhi nxori ftesën. Tjetri s'e priste. Ngurroi disa çaste, pastaj me ngutjen se ora po kalonte, lëshoi një «mirupafshim nesër në zyrë» dhe u nis vrap drej Pallatit. Bardhi e ndoqi me sy se si çante midis turmës. Një buzëqeshje e hidhur iu end në fytyrë. Një grimë herë qëndroi me vështrimin nga hyrja e pastaj nisi të shëtiste i vetmuar. Lloj-lloj mendimesh i vinin në kokë. E ndiente se midis tij dhe Remziut

ishte krijuar një boshllëk, diçka sikur ishte gati të këputej. U mundua ta zbante këtë mendim, po qëndrimi i shokut e çudiste...

— Bardhi! — e shkëputi nga mendimet një zë që iu duk i njohur. Në çast u gjend në krahët e dy të rinjve. Ishin Pertefi, një shok montator që tashti punonte në një nga veprat e pesëvjeçarit në Jug, dhe Spiroja, inxhinier në një ministri.

— Ç'bën, Bardhi?! Mirë që dole një herë, — tha Spiroja.

— Do shohim një projekt në institut, — tha Bardhi. Dhe sepse e gëzoi ai takim.

— Po hë, si janë shokët? Ç'kemi ndonjë të re?

Ndërsa shëtitnin, Bardhi u foli edhe për projektin e për ndryshimet që mendonin të bënin. Shokët e pyetnin për gjëra të veçanta dhe Bardhi jep-te hollësisht.

— Është me të vërtetë një gjë e mirë, — tha Spiroja. — Apo jo, Pertef?

— Ore, po janë qerratenj këta! — qeshi Pertefi.

— Apo s'kanë në kantier edhe atë Gëzimin! Ç'bën, aman, ç'bën Gëzimi, e ndez akoma me llullë?

Një copë herë folën për shokët.

— E dini çfarë, — tha Spiroja, — nuk shkojmë e shohim festivalin në televizor? Pertefin e kisha ftuar sonte, kurse për ty, Bardhi, një lugë do të shtëhet në tryezë!

Pas pak, të ulur në karrige, ndiqnin me vëmendje festivalin. Këngët ishin të bukura. Sidomos kur u këndua një për montatorët, në dhomë u ndie gjallëri. Kamera lëvizte sa andej-këndej dhe herë-herë fiksonte shikues të veçantë, që ndiqnin me vëmendje koncertin. Papritur kamera u fiksuu diku

nga rreshti i mesit. «Remziu», sa s'thirri Bardhi tek pa shokun që ishte mbështetur në karrige. Me sa dukej, Remziu e ndiente se në ato çaste kamera ishte drejtuar nga ai, sepse nxitoi të rregullohej në karrige për të dalë sa më mirë.

— Shihe, more, shihe si krekoset, — qeshi Per-tefi duke i rënë Bardhit me bërryl.

Bardhi uli sytë dhe sepse e ndjeu edhe ai veten në faj. Remziu ishte shoku i tij. Pesë vjet kishin qenë bashkë në fakultet. Por nuk iu duk e përshtatshme ta hapte bisedën për të. Do ta takonte të nesërmen.

NJË NATË E VITIT TË RI

Sa hapi derën, Andrea ndjeu menjëherë ngrohësinë e familjes. Blerina po vishte Ilirin dhe këndonte nën zë, me një mërmërimë të lehtë që përhaptej nëpër dhomë. Djali shihte nënën si me habi dhe lozte me flokët e saj. Herë-herë, ajo u binte dogkave të tij të vogla dhe e qortonte me përkëdheli. Ai gugiste me një zë të hollë, duke zbuluar dy dhëmbë të bardhë, që sa i kishin dalë. Në nim, nëna plakë e Andreas ngrinte sytë nga thiletë e trikos që punonte dhe, duke parë mbi gjyzlykë, qeshte me nusen e me nipin.

— O, erdhi babi! — thirri Blerina dhe e ngriti djalin në krahë.

Andrea i puthi të birit dy faqet e kuqe.

— Hë, u bëtë gati?

— Ja, edhe pak.

— Nënë, ti nuk do të mërzitesh. Do të kthehemi shpejt, — i tha Andrea duke e përqaftuar, sikur t'i vinte zor që do ta linin vetëm.

— Shkoni, shkoni ju, po kini kujdes djalin!
— porositi nëna.

Ata dolën. Salla ku do të bëhej mbrëmja e Vitit të Ri për pionierët e dalluar ishte plot. Në mes ishte vënë një bredh me ca fjolla pambuku si flokë bore dhe i stolitur me gjithfarë lodrash. Muret ishin zbukuruar me vizatime e piktura. Disa shoqe e shokë të Andréas e afruan Ilirin dhe e përkëdhelën. Sania la në faqet e vogëlushit shenjat e të kuqit të buzëve dhe, nga ky shkak, ata që u ndodhën përreth filluan të qeshnin. Pastaj Hamdiu, një mesoburrë, e mori në krah duke e mbuluar me të puthura. Djali në fillim u hutua, por pas pak e mori veten e zuri të hidhej duke tundur këmbët. U dëgjuan tingujt e muzikës. Në sallë u derdhën disa grupe fatosash e pionierësh, të zënë për dore dhe hodhën valle rreth pemës. Me ta u bashkuan edhe fëmijë të tjerë. Pas pak gjithçka u përfshi në vorbullën e gëzimit të festës. Tek shihte djalin të gëzonte, Andrea ndihej i kënaqur dhe mendonte se kishin bërë mirë që e kishin marrë me vete. Ndërkohë i tërhoqi vëmendjen zëri i Hamdiut, që ishte ulur në krah të Blerinës.

— I morët pako Ilirit? — pyeti ai.

— I morëm, — tha ajo. — Mora unë në qendrën e punës.

— Çfarë i ra?

Gruaja bëri buzën në gaz.

— Një makinë dhe një top i vogël. Iliri i vogël dhe topi i vogël! — qeshi ajo duke parë nga djali.

— S'i paska rënë gjë! — rrudhi buzët Hamdiu. Pastaj, si të ishte kujtuar për diçka, u kthye nga fëmija dhe picërroi sytë: — Do të të bjerë xhaxhi Hamdiu pako ty. Ty-ty-tyy! — ia shtypi hundën. — Veç kur ta shohësh!

— Çfarë? — pyeti Blerina.

— Pako, — tha Hamdiu. — Pako nga këto që do të marrin sot pionierët e dalluar. Dó të rregulloj patjetër një edhe për Ilirin. Apo s'e kemi vogëlush të dalluar! Ty-ty-tyyy! — luajti përsëri me fëmijën.

— Jo, — tha Blerina. — Iliri as që është në listë për pako.

Hamdiu bëri sikur s'dëgjoi. Tundi kokën si me çapkëllëk, u ngrit dhe pa nga Andrea me bisht të syrit. «Ç'do ky? Ku ta ketë hallin?» — tha me vete Andrea. U afrua tek e shoqja dhe ajo i tregoi.

Hamdiu punonte në të njëjtin sektor ku Andrea kishte pak kohë që drejtonte. Ditën e parë, kur kishte filluar punë, shokët e kishin uruar që në mëngjes, ndërsa Hamdiu kishte ardhur më vonë. I kishte buzëqeshur duke i shtrënguar dorën.

— Mirë se erdhe, shoku Andrea! Të prisnim!

Andrea u habit pak me këto fjalë. Megjithatë nuk e bëri veten. Tjetri sepse i erdhi nja dy herë rrotull dhe i zgjati paqetën e cigareve.

— Ndize njëherë, se ai i pari s'para pranonte as duhan nga ne.

— Kush?! — u habit Andrea. — Për kë e ke fjalën?

— Për atë mikun që ishte në këtë vend para

jush. Kishte vendosur të më qarkullonte, por ç'e do se... — Ai e la fjalën përgjysmë dhe bëri me dorë duke fishkëllyer, si të donte të thoshte: «Iu dogjën kartërat në duar.»

— Falemnderit, nuk e pi, — tha Andrea. Ishte vrenjtur në fytyrë. Nuk i pëlqeu Hamdiu. Megjithatë, u përpoq ta harronte këtë rast, duke menduar se nuk duhej shpejtuar në vlerësimin e njerëzve. Por ja që...

E ndoqi për disa çaste me vështrim të mërzitur. Hamdiu ecte nëpër qoshet e sallës dhe dikë kërkonte. Takonte njerëz të ndryshëm, qeshte me ta dhe lartgohej. Diku, pranë hyrjes, takoi Nakon, një punonjës të bashkimeve profesionale. Të dy biseduan gjatë. Nakoja diçka bënte me kokë në shenjë mohimi. Hamdiu diç i pëshpëriti te veshi. Nakoja e pa me habi dhe, duke e ruajtur atë shprehje habie në fytyrë, pa andej nga ishte Andrea. «Po ky qenka fare...», — tha me vete Andrea dhe ndjeu që po skuqej i tëri. Pse të ndodhte kjo? Ai nuk i kishte lënë vetes ndonjë rast që Hamdiu të mendonte se...

Në sallë kishin dalë humoristët dhe të gjithë sa ishin aty, të vegjël e të rritur, po gajaseshin së qeshuri. Për disa çaste edhe Andrea vuri buzën në gaz, por kapi zërin e Hamdiut që po i thoshte Blerinës:

— U rregullua ajo punë.

— Cila punë? — u vrenjt ajo.

— Një fëmijë nga fshati Vetëtima nuk vjen, se është i sëmurë. Kështu që pakon për Ilirin...

— Ç'na turbullon ujërat kështu, mor Hamdi! Ne s'kemi ardhur për pako këtu, — s'iu durua Andreas. E megjithatë e ndjeu se kishte thënë fare pak nga ato që mendonte.

Hamdiu në fillim uli kokën. Pastaj mori një pamje prej hokatari, sikur donte të thoshte: «I lini ato ju, sikur nuk e dashkeni!» Dhe humbi diku në fund të sallës.

Andrea pa nga Blerina. Ajo rrinte e menduar, me duart të lëshuara mbi gjunjë. Mbi sy i kishte rënë një bisht flokësh. E bezdiste dhe e largoi me dorë; u përpoq t'i buzëqeshte Andreas, por e pati të vështirë. Gëzimi i asaj mbrëmjeje sikur u kishte ikur të dyve. Vetëm vogëlushi qeshte me pafajësinë e vet, hapte krahët dhe bënte të hidhej në mes të sallës. «Kështu do të gëzonte edhe ai fëmija që ishte i sëmurë, — tha me vete Andrea. — Ai e ka pritur me padurim këtë pasdite të gëzuar. Por sëmundja... Tashti është shtrirë në krevat dhe ëndërron për mbrëmjen, për dhuratën që do të merrte»... Ndjeu një djersë të hollë që i buloi në fytyrë. Nxori shaminë dhe e kaloi mbi ballë, duke vështruar anash. Të gjithë gëzonin...

Kur pasditja mbaroi, ata u ngritën e bënë nga dera.

— Shoku Andrea, u kënaqët? — i foli dikush. Ishte Hamdiu.

Andrea vetëm sa ktheu kokën dhe iku pa i folur.

— Epo mirupafshim, mirupafshim, shoku Andrea! — thirri Hamdiu. — Dhe, ju lutem, të më falni! — kërkoi ndjesë pastaj, duke ruajtur gjithnjë tonin e njeriut dashamir.

Rrugën e bënë në heshtje. Andrea e ndiente veten të lodhur dhe vazhdonte të ruante atë mërzinë e lehtë.

— Erdhët? — i pyeti nëna. — A u kënaqët?

— Po, nënë, po, — mërmëriti ai.

Nëna mori Ilirin në krah.

— Hajde, të keqen gjyshja, hajde, të të jap pakon. Ehee, kanakari i gjyshes, ja ku u bëre me dy pako!

— Çfarë?! — Andrea u shtang, ngriti sytë dhe pa nga Blerina.

— Një djalë i vogël e solli. Është për Ilirin, — tha nëna. — Ia kishte dhënë... Uh, korba, ma tha emrin, po më doli nga mendja se kush ia kishte dhënë.

— Hamdiu?

— E, Hamdiu, e humba fare dhe unë. Po ç'patët ju?

— Hiç, hiç, — u mundua ta fshihte tronditjen Andrea. — Po ku e ke pakon? — pyeti pastaj.

Nëna u fut në kuzhinë me Ilirin në krah dhe pas pak solli një pako të madhe të mbështjellë bukur. Andrea e mori në dorë. Për disa çaste asnjëri nuk foli. Pastaj papritur, sikur t'i kishte ardhur një mendim vetëtimthi, u drejtua nga telefoni.

— Alo, alo, agjencia?... Ju lutem, kur niset autobusi për në Vetëtimë?... Në ç'orë?... Po, po, e mora vesh. Ju falem nderit!

Uli receptorin dhe vuri re se nëna po e vështronte e habitur.

— Ka ndodhur diçka, ashtu, nënë. Do të ta thotë Blerina.

Mori pakon dhe, ndërsa dilte, i tha së shoqes.

— Kthehem shpejt. Do të gjej njeri te agjencia...

Jashtë u dëgjuan hapat e tij nëpër shkallë.

MËSIMI I PARË

Zhurma e gëzueshme e mbrëmjes kishte kohë që kishte pushuar dhe në qytetin e studentëve mbretëronte qetësia. Ishte një qetësi ndryshe nga ajo e netve të tjera. Të nesërmen do të fillonte dita e parë studenteske dhe ata që ishin të rinj, e kishin si natë premiere.

Astriti kishte ngulur vështrimin diku në një pikë në errësirë dhe, kur ndiente kërcitjet e krevateve e pëshpëritjet e shokëve, shkëputej nga mendimet dhe sepse bënte buzën në gaz.

Papritur dëgjoji zërin e ulët të Nikos:

- Astrit, po fle?
- S'më zë gjumi.
- As mua, se ç'kam.

Të dy heshtën një copë herë. Pas disa çastesh Nikoja foli përsëri:

— Të paktën të na caktojnë në një grup!

— Të shohim, mua mirë do të më vinte.

— Po ti mund t'ia thuash një fjalë atij dhe...

Kuptohet pastaj!

Astriti s'foli. Solli në mend fytyrën e hajthme të pedagogut për të cilin e hidhte fjalën Nikoja. Ata ishin njohur në Lezhë, në kantieret e punës për zhdukjen e pasojave të tërmetit. Pastaj, sa herë që u jepej rasti, i dërgonin të fala njëri-tjetrit. Astriti i kishte shkruar për ardhjen në fakultet dhe të nesërmen patjetër do ta takonte. Po u kujtua që Nikoja priste përgjigje... E si t'i thoshte ai pedagogut? Na rregullo në një grup! Sikur kjo nuk shkonte fare.

— S'mund t'i them, Niko... Pastaj, sido që të bëhet, njëlloj do të jetë.

— Ja, po...

Ata u hëngrën një copë herë me zë të ulët. Gjumi i zuri vonë.

Të nesërmen në mëngjes studentët u ndanë në grupe dhe ndodhi që dy shokët i caktuan bashkë. U erdhi mirë, sidomos Nikos. Ai e shikonte shokun me gëzim gati fëmijnor, qeshte i kënaqur dhe, një çast, ai e kapi për krahu e i tha entuziast:

— Shkojmë e takojmë pedagogun?

Pedagogun e kërkuan një copë herë nëpër ambientet e fakultetit, po nuk e gjetën. Pasdreke, ndërsa Nikoja vajti në sallën e lojërave, Astriti doli në qytet. Por, meqenëse nuk takoi ndonjë të njohur, u kthye shpejt. Në dhomë gjeti studentë konviktorë. Midis disa djemve që nuk i njihte, Ni-

koja, me fytyrë të skuqur nga të qeshurit, po tregonte diçka duke lëvizur duart. Ata të tjerët qeshnin dhe e nxitnin të tregonte akoma. Ama, ç'tip i shkathët që është! — u kënaq me vete Astriti. — I vetmi është për të zënë shoqëri të re.

— Shoku im, dhe shokët e mi! — i paraqiti Nikoja.

Astriti u takua me djemtë. Njëri ishte i gjatë e me fytyrë të mprehtë, ndërsa dy të tjerët të shkur-tër dhe të shëndetshëm.

— Në cilin grup jeni? — pyeti ai më i gjati me një ton intim, që vinte prej dëshirës për të hapur bisedë.

— Në... — Astriti s'arriti ta mbaronte fjalën, se Nikoja e ndërpreu:

— Jemi bashkë në një grup. Top, ore, top fare!

Djemtë tundën kokat të kënaqur dhe pastaj njëri prej tyre pyeti përsëri:

— Keni mbaruar gjimnazin?

— Jo, një shkollë profesionale të mbrëmjes. Kam punuar disa vjet punëtor dhe kam kohë që jam shkëputur nga shkolla. Kështu që... — Astriti hapi duart, si të thoshte: «Ju e kuptoni edhe vetë, që do ta kem ca të vështirë!»

— Kot merakoset, — u hodh Nikoja. — Ky zë-re se e ka marrë vitin.

— Si, pa dhënë fare provim?! — qeshi me atë siguri të Nikos djaloshi i gjatë. Të tjerët vunë buzën në gaz dhe Astritit nuk i erdhi mirë.

— E ka shok njërin nga pedagogët, — sqaroi Nikoja. — Kanë qenë bashkë në një aksion...

Astriti e ndjeu veten ngushtë.

— Nikoja bën shaka, — tha. — Unë vërtet e

njoh pedagogun, por, si i thonë fjalës, ai është pedagogu im, dhe unë student i tij.

— E mo, lëri këto ti! — u hodh përsëri Nikoja, por e ndjeu se, mbase, e teproi. E kuptoi këtë sidomos kur ndeshi në vështrimin e Astritit.

Pas kësaj biseda po zvarritej. Djemtë, si ta kishin bërë me fjalë, uruan «natën e mirë» dhe dolën. Të dy shokët mbetën vetëm. Pas një heshtjeje që zgjati disa minuta, Nikoja u ngrit e doli jashtë. Pa ditur ç'të bënte, Astriti hapi valixhen dhe nisi të rremonte aty. Ato fjalët e shokut e kishin rënduar.

Në darkë nuk e zunë më në gojë. Por të nesërmen Astritin përsëri sikur e mundonte diçka. Për çudi, ai vuri re se Nikoja e kishte harruar ngjarjen e pasdrekës. Shkonte e vinte në korridorin e auditorit dhe herë-herë fliste me zë të lartë, duke i treguar një studentit se si kishte arritur të fitonte për një pikë një ndeshje pingpongu. Madje ai vazhdoi po me atë ton të ngritur edhe kur u bashkua me Astritin. Nuk kaloi shumë dhe dikush i foli Astritit. Nikoja e mori me mend se kush duhej të ishte ai që i foli.

Pedagogu i zgjati dorën i pari dhe Astritit sepse i erdhi mirë që tjetri e priti ashtu, me krahë hapur. Ai sikur kishte nevojë pikërisht për këtë. Kur pa edhe Nikon aty pranë, pedagogu hodhi një sy pyetës nga Astriti.

— Një shoku im, — e njohu ai.

— Ashtu!? — pedagogu i shtrëngoi dorën Nikos dhe e pyeti: — Në një grup jeni?

— Jo vetëm në një grup, por edhe shokë të ngushtë, — tha Nikoja, i kënaqur.

...Kaluan ditë dhe po afronte seminari i parë. Astriti mbrëmjeve mblidhej shpejt dhe studionte. Nikoja kthehej vonë. Vinte në dhomë drejt e nga salla e lojërave dhe sillte informacion për ndeshjet. Atij i pëlqente të komentonte veçanërisht ndeshjet më të forta të pingpongut që, për çudi, dilnin shpesh me një pikë diferencë.

Ndërkohë takoheshin nganjëherë me pedagogun. Një pasdite ai i ftoi edhe në shtëpi. Nikoja s'e hiqte nga goja: «S'ka si ai!» — thoshte dhe nganjëherë, pas këtyre fjalëve, ia merrte me të fishkëllyer.

— Je përgatitur, Niko? Pasesër kemi seminar, — e kujtoi Astriti.

— E ç'do të përgatitem? S'kemi ndonjë gjë të vështirë. Megjithatë diç kam lexuar.

Astriti sepse ndjeu një pezmatim dhe nuk i pëlqeu ai qëndrim i shkujdesur.

Ditën e seminarit studentët qëndronin në pritje, me vështrime të mbërthyera mbi fletoret e leksioneve. Të gjithë i kishte përfshirë shqetësimi për seminarin e parë dhe asnjëri nuk fliste. Ndonjëri, që me sa dukej donte t'i jepte kurajë vetes, bënte shaka. Të dy shokët ishin ulur në një tavolinë. Astriti kishte njëfarë emocioni të veçantë që, ndoshta, vinte më tepër dhe nga njohja me pedagogun. Nuk donte kurrsesi të turpërohej. U dëgjua zhurma e lehtë e derës dhe në klasë hyri pedagogu. Ai përshëndeti duke u afruar te katedra. Pasi hapi një fletore, ngriti sytë dhe pyeti:

— Kush do të flasë?

«Ashtu de, ky të çoka me dëshirë. Kështu po!» — tha Nikoja me vete. Nxori një bllok shënimesh

dhe zuri ta shfletonte. Pák nga pak atij iu duk sikur vështrimi i pedagogut po përqendrohej pikërisht tek ai. U mundua t'i shmangej disi, po ja ku u ngrit një studente. Nikoja psherëtiu i lehtësuar. Vajza u përgjigj mirë dhe pedagogu mbeti i kënaqur. Pastaj ngriti Astritin. Nikoja e zuri nga dora poshtë tryezës, sikur po i thoshte: «Kot shqetësohesh, ndonjë pyetje të lehtë ka për të të bërë!» Por mbeti i zhgënjyer.

Astriti nisi të fliste i qetë dhe i sigurt. Prit kur ta ulë tani dhe t'i thotë «shumë mirë», mendoi Nikoja. Por u habit përsëri, kur pedagogu i drejtoi pyetje të tjera. Njërës prej tyre Astriti nuk qe në gjendje t'i përgjigjej dhe uli sytë, duke u skuqur.

— Mirë, — e qetësoi pedagogu, — lëndën e zotëron. Mbase mund të bësh më tepër për t'u thelluar në konkluzione.

Astriti u ul dhe pa me bisht të syrit nga Nikoja, i cili ruante atë pamje habie dhe dukej sikur diç donte të thoshte...

Në mbrëmje u takua rastësisht me pedagogun. Ai sapo kishte dalë nga Biblioteka Kombëtare dhe bënë bashkë një copë rrugë. Gjatë bisedës, kushedi përse, Nikoja mezi tha nja dy-tri fjalë. Herë-herë i shikonte ata të dy si me druajtje.

E përcollën pedagogun dhe pastaj morën rrugën e konviktit. Ndërsa i afroheshin ndërtesës së tyre, Astriti i ra me bërryl në krah.

— Po hë, ç'të gjeti që më rri si mumje?

— S'kam gjë, jo.

— Që ke diçka, e shoh, por se çfarë ke pikërisht, këtë nuk e di, — e ngacmoi tjetri.

Nikoja i shkeli syrin siç bënte nganjëherë.

— Këtë kam, — tha.

— Si këtë?

— Po ja, pra, mendjelehtësinë... A do të ta them troç? Kisha filluar të mendoja se me këtë pedagogun, për shkak... për shkak... Me një fjalë, do ta kisha grurë.

— E çfarë, — qeshi Astriti, — të doli thekër! Njëlloj është, — e ngacmoi prapë, — edhe thekra kërkon djersë. Por kërkon gjithashtu t'i hapësh kashtën, — qeshi prapë.

— Po, xhanëm, po, — mërmëriti Nikoja. Eh, se si i marr dhe unë gjërat nganjëherë! — Në ankimin e tjetrit Astriti ndjeu një notë vetëqortuese.

Mbase Nikoja ndodhej përpara atyre mësimeve të para që, shpesh, jeta t'i jep si pa u kuptuar.

TIKU

— Më kanë adresuar te ju, — i thashë duke buzëqeshur dhe i shtrëngova dorën.

Përpara meje qëndronte një djalosh nja njëzet e tre vjeç, me trup mesatar, flokëdredhur e me një fytyrë të mprehtë, ku spikatnin sytë e kaltër e të thellë. Mbi kostumin prej doku kishte veshur një peliçe të zezë, ndërsa në këmbë një palë opinga llastiku. «Ja dhe Tiku», thashë me vete. Kaq herë kisha dëgjuar të flitej për të nga shokët që kishin ardhur me shërbim në hekurudhë. Ndërkohë që e kundroja me kërshtëri, Tiku vazhdonte të më tundte dorën me një buzagaz të lehtë e pa m'i ndarë sytë.

— Mos e ke shërbimin e parë? — më pyeti.

— Pse, e tregon pamja ime?! — qesha.

— Të vura re së largu. Çdo gjë e sheh me kurreshtje.

— Ashtu është, — pranova, — ka gjëra që vërtet të bëjnë përshtypje.

— Shkojmë nga dhoma, — tha ai.

Më hoqi udhën midis ndërtesave që përbënin sektorin. Ishte pasdite janari dhe çdo gjë përreth e kishte mbuluar një shtresë dëbore. Ndanë sektorit kalonte traseja dhe rruga automobilistike, ndërsa më tutje rridhte me zhurmë lumi, që humbiste tej grykave e kodrave. Pas pak u gjendëm në një dhomë të vogël e të pastër. Një tavolinë, disa karrige, krevati dhe një raft me libra të binin menjëherë në sy.

— Do të flesh këtu, — më tha ai.

— E keni për miqtë këtë dhomë? — provova ta ngacmoja. S'e kisha menduar se mund të flija në një dhomë aq të rehatshme.

— Çlodhu disa orë. Në mbrëmje do vij të të takoj. — Më shtrëngoi dorën dhe u largua me të shpejtë.

Disa çaste bëra ecejake. Pastaj, meqë e ndieja veten të lodhur, u shtriva me shpresë mos merrja një sy gjumë. Por shqetësimi për shkrimin që duhej të bëja, s'më linte të qetë. Edhe gjatë udhëtimit më tren kisha menduar për këtë. M'u kujtua biseda me sekretarin e kolegjumit. E kisha shkrimin e parë dhe ai më kishte mbushur me porosira.

Më duket se pak nga pak më kishte mundur gjumi, sepse nuk e ndjeva Tikun kur hyri në dhomë. U zgjova nga një e prekur e lehtë në krahë. Përpara meje qëndronte ai. Pashë orën: akrepi i vogël po i afrohej nëntës.

— Paskam fjetur goxha, — thashë si i turpëruar, duke fërkuar sytë.

— Do të shkoj në sektorin e Bushtricës, — tha Tiku. — Vjen?

— Tani? Po ç'do të bëjmë tani atje?! — pyeta i çuditur. Kisha pandehur se ai do të vinte më shpejt, do të më jepte ndonjë të dhënë për shkrimin dhe të nesërmen do të dilnim bashkë në trase. Por ja që...

— Këtu s'punohet vetëm ditën, — qeshi ai. — Dhe as nuk flihet vetëm natën, — shtoi prapë me shaka. Seç kishte diçka në ata sytë e tij të kaltër që të bënin për vete.

U veshu. Pas pak dolëm të dy në xhade. Në sektor shkonin e vinin brigada vullnetarësh. Ndërroheshin turnet. Qielli ishte i kthjellët e pa një re, ndërsa hëna luante me dritën e saj në pasqyrën e dëborës. Bardhësia të lëbyrte sytë dhe gjithçka përreth dukej si në pëllëmbë të dorës. Një makinë betoni ndaloi me zhurmë pranë nesh dhe hipëm. Shoferi, një djalosh i zeshkët, që doemos e njihte Tikun, bëri me kokë nga unë:

— Nga e kemi këtë shokun? — pyeti.

— Se nga e kemi, nuk e di, por se nga ka ardhur, e di mirë, është gazetar! — më paraqiti me humor Tiku.

Shoferi tundi kokën prapë dhe heshti. Ndihej vetëm zhurma e motorit dhe fishkëllima e erës që po shtohesh.

— Në Bushtricë? — pyeti shoferi duke thyer heshtjen.

— Po.

— Mbaroi montimi në Xhyrë?

— Po, sot nga ora dy e mëngjesit, — tha Tiku.

— Edhe ne zotimin e kemi për nesër. Mëngjesi duhet t'i gjejë të shtruar...

S'po kapja fillin e bisedës, me gjithë dëshirën që kisha. S'më mbetej tjetër veçse të pyesja. Po pse, pak e kisha pyetur Tikun?! Duke menduar se ka disa gjëra që duhet t'i marrësh me mend vetë, s'bëra zë.

Tiku kishte ngulur vështrimin tej xhamave. Dukej i menduar. Pastaj, papritur nisi të këndonte nën zë. Fytyra i mori një shprehje të ëmbël dhe sytë e kaltër i hodhi me një gëzim gati fëmijnor nga shoferi, që zuri ta shoqëronte. Ishte një këngë për një nga dëshmorët e aksioneve. Tiku kishte zë të mirë dhe këndonte shtruar. Kënga thoshte:

*Një mall, një dashuri ndiej
dhe m'shfaqet fytyra jote...*

Unë nxora bllokun dhe u përpoqa t'i shënoja fjalët e këngës. Kur kënga mbaroi, Tiku u kthye nga unë:

— Mos u bëj merak, se do të kesh aq shumë për të shkruar, sa s'do të dish nga t'ia fillosh.

— Se mos na ndodh si atëherë? — Shoferi i shkeli syrin Tikut.

— Jo, — tha Tiku dhe u kthye nga unë. — E ka fjalën për një kolegun tënd. Erdhi këtu një pasdite, mori disa shifra nga zyra dhe po atë natë u nis që të bënte shkrimin. Mirëpo të nesërmen u kthye përsëri...

Qesha bashkë me ta. Pas një kthese u shfaq sektori i Bushtricës.

— Këtu, — tha Tiku.

— Nuk do të futeni në sektor?

— Do të ngjitemi në trase, — i tha shoferit.

Takuan duart dhe makina iku, duke ngritur cilfla dëbore.

— Në trase sonte është nata e fundit e montimit të shinave, — tha Tiku.

Gjatë rrugës më kishte munduar kërshtëria për atë udhëtim: çfarë do të nxirrja për shkrimin? Por tani që u bë çdo gjë e qartë, sepse ndieja njëfarë sigurie.

Filluam t'i ngjiteshim një shtegu. Ai ecte përpara, duke më hapur rrugën nëpër dëborë. Kisha ngulur vështrimin në gjurmët që linin opingat e tij dhe mendoja për variantet e shkrimit. Në fillim do të përshkruaja... pastaj... dhe fantazia ime fluturonte. Mendimet më përziheshin. Përftytyroja shprehjen që do të merrte fytyra e sekretarit të kolegjuimit kur ta lexonte. Kisha dëgjuar se ai, në përgjithësi, s'kënaqej lehtë. Po me atë shkrim patjetër do ta kënaqja. Mundet që t'u rekomandonte edhe... Po e teproja dhe kushedi se ku do të më çonte fantazia sikur të mos kisha dëgjuar zërin e qetë të Tikut:

— Edhe pak dhe erdhëm.

Kur dolëm mbi trase, para nesh u shfaq një pamje që të kënaqte syrin. Një gjallëri e pazakon-të dukej mbi bardhësinë e dëborës. Ishin ndezur projektorët. Vullnetarët venin e vinin duke mbartur shina dhe traversa. Dëgjohej zhurma e çekiçëve, ca thirrje dhe era, që aty lart frynte më e fortë. Herë-herë era sillte tingujt e një kënge. Andej dukej

flamuri i një brigade, ku lexohej qartë emri i një dëshmori.

— Erdhi Tiku, — sekush tha kur ne u afruam. Disa të rinj ngritën kokën dhe na buzëqeshën. Pas disa çastesh, edhe Tiku nisi të mbartte traversa. Poshhtë xhadesë lëviznin pa pushim makina. «Sonte të gjitha qenkan zgjuar», — thashë me vete. Koha kalonte dhe dukej sikur askush s'e vuri re se drita e hënës u mpak dhe humbi. Diçka e butë dhe e lagët po binte mbi supet tona. Dëborë e re. Të ftohtët u shtua dhe ndjeva që lagështia po më hynte në trup.

— Si do t'i bëhet hallit tashti? — pyeta Tikun, pa e fshehur shqetësimin dhe u përpoqa ta shihja në fytyrë. Ai heshti një çast dhe pastaj bëri me dorë nga vullnetarët, që grumbulloheshin pranë flamurit.

— Shkojmë atje. Ata për këtë gjë do të diskutojnë.

U afruam. Po fliste një vajzë, që, me sa dukej, ishte komandante brigade.

— Ç'mendim keni, shokë? — pyeste ajo.

Për disa çaste pasoi një heshtje e thellë. Pastaj vullnetarët filluan të pëshpëritnin. Një djalë trupvogël doli në krye.

— Unë mendoj që atje ku montohen shina të ndezim zjarre. Besoj se do t'ia dalim. Këtë e kemi provuar edhe herë tjetër, — tha përsëri djaloshi.

— E provojmë edhe ne atëherë, — tha vajza.

Ata u shpërndanë për të mbledhur karthje nën dëborë dhe pas disa çastesh traseja u ndriçua nga zjarre të vogla. Filloi të dëgjohej përsëri goditja e çekiqëve. Dëborë vazhdonte të binte me flokë të

mëdhenj. Aty pranë meje, në dritë të zjarrit, një vajzë vendoste gozhdë të mëdha mbi pllakën metalike, ndërsa një djalosh godiste me çekiçin e rëndë. Kishe qejf t'i shikoje fytyrat e tyre, ku luanin refleksët e zjarrit. «Pas disa ditësh ata do të shkojnë në vendlindjet e tyre, mendova, dhe këtë natë do ta kujtojnë në bisedat me shokët dhe prindërit. Ndoshta do t'i shkruajnë njëri-tjetrit. Ndoshta dhe... e përse jo?» — qesha me vete me profecinë se ata të dy mund të dashuroheshin. Dikush më preku në sup. Ishte Tiku.

— Unë po shkoj andej nga sektori tjetër, — më tha. — Ndoshta s'u shkon mendja për zjarre.

— Të vij dhe unë?

— Rri këtu më mirë. Vetëm edhe unë mund të arrij më shpejt.

Pas pak silueta e tij humbi në errësirën e natës...

*
* *
*

Po fillonte të zbardhte. Ndërsa vullnetarët ecnin drejt sektorit duke kënduar, unë eca trasesë dhe dola në xhade. Isha lagur pak. Zhurma e një makine që ndaloi disa hapa larg, më këputi fillin e mendimeve.

— Hajde, shoku gazetar! — njoha zërin e shofer Kujtimit. — Në sektor? — më pyeti kur hipa.

— Po.

— Shtrimi i shinave mbaroi, e more vesh? — deshi të më gëzonte ai.

— Po, isha atje, — i thashë.

— Ashtu, ë!? Paske ndenjur me Tikun, dome-
thënë. Epo, do bësh ndonjë shkrim të mirë, besoj?
Shkruaj çfarë pe dhe s'ke nevojë të shtosh asgjë
nga xhepi, — qeshi.

— Të shohim, — buzëqesha.

Ai kishte folur me qetësi të madhe, pa e hequr
vështrimin nga rruga. E kundrova një grimë herë
me vëmendje. Sepse më vunë në mendime fjalët e
tij. «Presim një shkrim të mirë» — m'u kujtuan fja-
lët e sekretarit të kolegjumit. Një copë herë humba
vështrimin tej xhamave të makinës. Po më dukej e
njohur dhe e dashur çdo gjë që shikoja. Edhe malet
e ngarkuara me dëborë, edhe traseja me shinat për-
mbi kurriz, edhe ato pemët, që...

— Mos ma merr për keq, — më shkëputi men-
dimet zëri i Kujtimit.

— Jo, jo, — qesha, duke e parë me ngrohtësi.
— Ju thatë një të vërtetë të bukur. Në ndonjë rast
ne i mbushim shkrimet me shifra dhe harrojmë nje-
rëzit, punën, përpjekjet... Ja, mbrëmë unë pashë...
— Fillova t'i flitja për mbresat e asaj nate dhe çudi-
tesha edhe vetë sa me lehtësi po i gjeja fjalët. Sim-
patia dhe vëmendja që tregonte Kujtimi, sikur më
frymëzonin.

— Ja, këto shkruaji, — tha Kujtimi kur mba-
rova.

Isha skuqur në fytyrë dhe për një çast m'u duk
sikur u bëra qesharak nga ai shpërthim ndjenjash:

— Ashtu do të bëj, — i thashë me mirënjohje.

— Ti ke nevojë të ndërroresh e të qetësohesh.
Do të të çoj në dhomën time, — tha Kujtimi.

— Të falem nderit, po e kam një dhomë në
sektor, — i thashë.

— E... ë, te Tiku, më doli nga mendja! — ia bëri ai.

— Pse, dhoma e tij është ajo?

— S'e ditke?! — Ai më pa një çast pa folur, pastaj qeshi me zë dhe vazhdoi: — Tiku është njeri mikpritës. Kur vijnë miqtë, zakonisht, aty flenë.

— Po ai vetë?

— Ai!... Ndoshta fle te ndonjë shok, ndoshta... s'e di ku fle, sepse atë njeri më duket sikur gjithnjë e gjen sektorëve dhe nëpër trase.

E pashë në dritë të syrit Kujtimin. Dhe prej asaj drite sikur më hynte në zemër diçka e re dhe e gëzueshme për këta njerëz të thjeshtë të kantierëve.

Tikun e prita tërë atë ditë, por ai nuk erdhi. «Kur të shkosh, çelësin lëre mbi derë», — më kishte thënë. Ndoshta kjo kishte qenë një shenjë se ai edhe mund të mos vinte. Mua s'më ikej pa e takuar. Po të nesërmen duhej të dorëzoja shkrimin. Materiale kisha mbledhur dhe kisha përpunuar variante për ta hedhur në letër.

Dola në rrugë dhe nisa të baritja një copë herë poshtë e lart. Një mendje më thoshte se Tiku do të vinte dhe sytë nuk i hiqja nga traseja. Më bëhej sikur e shikoja ashtu të veshur me peliçen e zezë, me ato opingat e llastikut dhe me atë nënqeshjen karakteristike në buzë, duke ecur mbi trasenë e pafund... U ula mbi një gur ndanë xhadesë dhe në mënyrë të pavetëdijshme mora letrën e lapsin. Nisa të shkruaja. Vegimi i Tikut, i vullnetarëve me të cilët punova një natë më parë dhe i Kujtimit s'më hiqeshin nga mendja. Më bëhej sikur një zë i fshehtë më fliste në vesh dhe unë shkruaja e shkruaja. Sa qëndrova ashtu? Pashë orën. Kishte kaluar goxha kohë. Shkri-

min tashmë e kisha filluar. Po Tiku si e ka emrin e plotë? — më erdhi në mend. Si s'e kisha pyetur! U shqetësova dhe, ndërsa ktheja kokën mos shihja njeri për ta pyetur, një mendim tjetër, që më lindi befash, më bëri të hiqja dorë. E përse të mos e quaj në shkrim thjesht, ashtu si i flasin të gjithë, Tiku? Dhe sa herë të kujtoj emrin e tij, do të kujtoj një njeri të mirë të aksioneve!... Ngazëlleva me vete dhe u ngrita për udhë.

PASQYRË E LËNDËS

ETJE QË SHUHEJ...	3
BASHKË	11
NATA ME SHI	20
DHURATA	29
MOZAIKU	35
BIE CYLJA	46
TË NESËRMEN IKU... ..	54
JO, NUK ISHTE AI	63
PRAPE NË KANTIER	69
LISI	77
FTESA	83
NJË NATË E VITIT TË RI	90
MËSIMI I PARË	96
TIKU	103